



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa Abdi Toptani", nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 470/31 Prot.

Tiranë, më 03/08/2019

V E N D I M
Nr.33 , Datë 03/08/2019

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË 22
SUBJEKTE "PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
MËPARSHME TË EVADUARA GJATË VITIT 2018".

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë vitit 2018, sipas Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 256, datë 31.12.2018 "Për miratimin e programit të veprimtarisë audituese të KLSH-së për vitin 2019", autorizimeve respektive, si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 "Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit", rezultoi se në 22 subjekte të audituar, janë rekomanduar gjithsej 454 masa, nga të cilat janë pranuar 436 masa dhe nuk janë pranuar 18 masa. Konstatuam se nga 436 masat e rekomanduara dhe të pranura janë zbatuar plotësisht 212 prej tyre ose 49%, zbatuar pjesërisht 5 masa, ose 1% e totalit të masave të pranura, dhe konsiderohen në proces zbatimi 168 masa ose 39%, pa zbatuar rezultuan 51 masa, ose 12%.

Analiza sipas llojit të rekomandimeve të dhëna paraqitet:

- 1. Masa për përmirësime ligjore** janë rekomanduar 14, nga të cilat janë pranuar 14 masa. Rezulton se nga masat e pranura janë zbatuar 7 rekomandime, dhe në proces zbatimi 7.
- 2. Masa organizative** janë rekomanduar 290 nga të cilat janë pranuar 288 masa dhe pa pranuar 2. Nga masat e pranura, janë zbatuar 153 rekomandime, kanë nisur procedurat për zbatim 94 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 3, dhe nuk janë zbatuar 38 rekomandime.
- 3. Masa zhdëmtimi** janë rekomanduar 52, për vlerën 407,934 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 39 masa në vlerën 314,617 mijë lekë, pa pranuar 13 masë në vlerën 62,065 mijë lekë. Nga masat e pranura, janë zbatuar 7 rekomandime në shumën 373 mijë lekë, në proces zbatimi 29 rekomandime për vlerën 333,467 mijë lekë, zbatuar pjesërisht 1 rekomandim në shumën 152 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 2 rekomandime, për vlerën 1,375 mijë lekë.
- 4. Masa disiplinore** janë rekomanduar 37, nga të cilat në 5 subjekte¹ lënë në kompetencë të titullarit; nga këto janë pranuar 37 masa. Nga masat disiplinore të rekomanduara dhe pranura 29 janë zbatuar plotësisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 6 janë pa zbatuar
- 5. Masa administrative** janë rekomanduar 16, të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi.

¹ Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Mbrojtjes; Drejtorja e Sherbimit të Trupit Diplomatik; Avokatura e Shtetit dhe Instituti I Shendetit Publik

6. Masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike janë rekomanduar gjithsej 45, në shumën 22,809,330 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 41 masa, në shumën 11,718,327 mijë lekë; nga 41 masat e pranuar janë zbatuar 15, në shumën 18,039 mijë lekë; janë në proces zbatimi 20 masa, në shumën 11,560,443 mijë lekë, zbatuar pjesërisht 1 masë, në shumën 15,059 mijë lekë, dhe pa zbatuar 6 masa, në shumën 115,301 mijë lekë

Në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga 22 subjektet e audituara 9 prej tyre nuk kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara, konkretisht: (*Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Fier, Drejtoria e Policise, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Avokatura e Shtetit, Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise, Gjykata Kushtetuese, dhe Ministria e Kulturës*)

Gjithashtu konstatohet se, 17 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, konkretisht: (*Universiteti Fan Noli, Korçe, Akademia e Shkencave, Drejtoria e Bordit të Ujitjes dhe Kullimit Durrës, Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Fier, AKBN, Drejtoria e Policise, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Univeristeti Bujqesor Tirane, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Avokatura e Shtetit, ISHP, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise dhe Ministria e Mbrojtjes*)

Bazuar në rezultatet e mësipërme mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin e Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar gjatë vitit 2018”, sipas Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 256, datë 31.12.2018 “Për miratimin e programit të veprimtarisë audituese të KLSH-së për vitin 2018” në 23 subjekte², si dhe autorizimeve respektive të datës 26.06.2019, me nr. 450/1, 450/2, 450/3, 450/4, 450/5, 450/6, 450/7, 450/8, 450/9, 450/10, 450/11, 450/12, 450/13, 450/14, 450/15, 450/16, 450/17, 450/18, 450/19, 450/20, 450/21, dhe 450/22.

II. TË RIKËRKOJ marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

1. UNIVERSITETI “FAN NOLI”, KORÇE

Nga auditimi i ushtruar në Universitetin “Fan Noli”, Korçë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 74, datë

² Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në bazë të kërkesës së këtij të fundit, u shty për një afat të dytë.

30.06.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 202/11, datë 30.06.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Universitetin “Fan Noli”, Korçë, **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja në përmbushje të afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **67** rekomandime gjithsej, nga këto, 2 propozime për përmirësime ligjore, 24 masa organizative, 9 masa zhdëmtimi, 16 masa administrative, 10 masa disiplinore, dhe 6 masa për eliminimin e fekteve negative në administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. **Masa për përmirësime ligjore** janë rekomanduar 2, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht .
- b. **Masa organizative** janë rekomanduar 24, të cilat janë pranuar plotësisht; nga këto janë zbatuar plotësisht 12, zbatuar pjesërisht 1, në proces 8, dhe 3 masa rezultojnë të pa zbatuara .
- c. **Masa për shpërblim dëmi** janë rekomanduar 9, për shumën totale 12,395 mijë lekë, pranuar 8 masa për vlerën 1,837 mijë lekë, dhe 1 masë e papranuar në shumën 56 mijë lekë. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 5, në shumën 171 mijë lekë, zbatuar pjesërisht 1 masë në shumën 152 mijë lekë dhe në proces zbatimi 1 masë në shumën 331 mijë lekë dhe 1 masë e pazbatuar në shumën 1,183 mijë lekë
- d. **Masa për eliminimin e efekteve negative** të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë lënë në total 6 masa në shumën 19,755 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 5, në shumën 18,373 mijë lekë dhe pa pranuar 1, në shumën 1,382 mijë lekë. Nga masat e pranuar, 1 masë është zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht, 1 masë është në proces zbatimi dhe 2 masa janë pa zbatuar.
- e. **Masa administrative** janë rekomanduar gjithsej 16, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë në proces zbatimi
- f. **Masa disiplinore** janë rekomanduar gjithsej 10, të cilat janë pranuar plotësisht; nga këto 6 janë zbatuar dhe 4 masa nuk janë zbatuar

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga Universiteti Fan Noli, Korçë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 202/11 datë 30.06.2018 mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

2. Gjetje nga auditimi:

Për vitin akademik 2016-2017, pagesa e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore nga 30 % deri në 70 %, pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i kohës së punës, është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin

shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe pikën nr. 20, të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Në vendim marrje Rektorati i Universitetit, Senati Akademik, Këshilli i Administrimit kanë kapërcyer kompetencat që ju jep legjislacioni i sipër cituar. Mos zbatimi i kuadrit ligjor ka sjellë si pasojë kryerjen e pagesës për 26,266 orë mësimore mbi normën vjetore të pedagogëve efektivë pa miratimin nga MARS, duke shkaktuar efekt financiar në vlerën 22,385,780 lekë. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/c, faqe 107-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Institucioni të marrë masa për vitin akademik 2017-2018, pagesa e personelit akademik për orët e mbingarkesës mësimore, pasi është plotësuar i gjithë detyrimi vjetor i kohës së punës, të kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e akteve ligjore në fuqi dhe vetëm pas marrjes së miratimit nga Ministri i Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Nga analiza e komponentëve përbërës të strukturës organike të miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr. 12, datë 26.12.2015 dhe nr. 11, datë 19.12.2016, konstatohet se, Universiteti nuk ka krijuar Sektorin e Auditit të Brendshëm si njësi organizative e veçantë. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/c , faqe 107-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Senati i UFSNK dhe Bordi i Administrimit, të marrin të gjitha masat për ngritjen e strukturës së auditimit të brendshëm, tre specialistë, të cilët duhet të jenë në funksion të përmirësimit të gjendjes menaxheriale të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, me qëllimin e përdorimit efektiv të fondeve publike dhe sigurimin e cilësisë së punës në Universitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi:

Shkelje dhe veprime me risk fiktiviteti në blerjen e librit për fondin e bibliotekës së Universitetit, me procedurën “Kërkesë për propozim” për vlerën **5 milionë lekë**, likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 349, datë 29.12.2016, në bazë të faturës tatimore të shitjes me nr. 784, datë 20.12.2016 për subjektin privat “E. C.” SHPK në shumën **4,848,370 lekë**.

Konstatimet:

- 1.** Çmimi total i ofertës financiare të paraqitur në kuadër të kërkesës për propozim, nga ana e operatorit të vetëm pjesëmarrës është në shumën 5,000,000 lekë pa TVSH, (ose kjo e barabartë me 100 % të vlerës së fondit limit sipas urdhër prokurimit). Po kështu, vlera e kontratës së nënshkruar nga OE me AK është në të njëjtën shumë prej 5,000,000 lekë, (ose e barabartë me 100 % të fondit limit).
- 2.** Nga ana e AK nuk ka gjetur zbatim pika nr. 4, e Nenit 39, “Kërkesa për propozim” e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku specifikohet se: “*Ne çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë*”. Nuk ka asnjë argumentim nga ana e NJP përse janë ftuar dy shtypshkronja dhe si mund të ofronin ato këtë nomenklaturë kaq të shtrirë të titujve të teksteve, kur një pjesë e madhe e tyre sigurohen nga ente prodhuese të huaja.
- 3.** Fatura tatimore e lëshuar nga subjekti privat, për palën e UFSNK është nënshkruar nga kancelarja, e cila është njëkohësisht në cilësinë e titullarit të AK, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- 4.** Në DST janë listuar dhe kërkuar të prokurohen 607 tituj librash, të cilat janë bazuar në listat e “Kërkesave për botime për fondin e bibliotekës së fakultetit”, të nënshkruara nga ana e dekanëve të fakulteteve. Nga ana e Fakulteteve nuk janë dërguar vetëm lista e titujve

të librave që u nevojiten, por krahas janë shënuar sasi të, çmimet dhe vlerat e tyre. Grupi i auditimit të KLSH vëren se, çmimeve të vendosura nga dekanët dhe ato të vënë në ofertën e vetme/ fituese të paraqitura nga operatori ekonomik si në tituj, sasi, çmimet për njësi dhe në vlerë janë absolutisht të njëjta, duke krijuar premisa për parregullsi e risk dhe procedura jorealiste të këtij prokurimi

5. Nuk është respektuar furnizimi me 607 tituj të librave të prokuruar, për të cilin OE ka fituar të drejtën e furnizimit në vlerën 5,000,000 lekë, por ka furnizuar 596 tituj ose 11 tituj më pak duke mos realizuar kontratën për 151,630 lekë. Ky fakt nuk është evidentuar nga Komisioni i marrjes në dorëzim të këtij artikulli. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/b, faqe 87-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Nga UFSNK, të analizohet, duke nxjerrë përgjegjësitë dhe ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për veprimet dhe parregullsitë e konstatuara.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

2. Gjetje nga auditimi:

Vendimmarrje nga Bordi i Administrimit në kushtet e konfliktit të interesit dhe dëmi ekonomik i arkëtueshëm nga përlllogaritja e gabuar për pagesat e kryera. Anëtarët e Bordit të Administrimit kanë përfituar padrejtësisht më tepër sesa përcaktimet ligjore dhe shpërblimi për Bordin e Administrimit është në konflikt interesi , me dëm në shumën **1,182,631 lekë**. Sa vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9584, date 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe VKM nr. 418, date 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësisive të qeverisjes qendrore”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 3/a, faqe 9-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **1,182,631 lekë**.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

Shkelje në respektimin e kuotave financiare të pritjeve dhe përcjelljeve zyrtare realizuar me rastin e 45 vjetorit të UFSNK, me dëm në vlerën 56,100 lekë, vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 3, të VKM nr.243, datë 15.5.1995, “Për pritjet, përcjelljet dhe trajtimin që u bëhen delegacioneve të huaja”, ndryshuar. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/a, faqe 9-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Nga UFSNK, të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **56,100 lekë**.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi:

U konstatua se, gjatë periudhës objekt auditimi (2016, 2017), janë kryer shpenzime dhe janë bërë dalje karburante për gjithë veprimtarinë mësimore dhe ndihmëse, në sasinë 99,984 litra dhe në vlerën 15,059,295 lekë pa asnjë dokumentacion justifikimi të këtyre

shpenzimeve. Sa sipër, është vepruar në shkelje të parimeve dhe kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 26.12.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe UMF nr.30. 20111 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe shuma prej **15,059,295 lekë** konsiderohet si shpenzim i kryer pa efektivitet. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/a, faqe 9-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

*Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara prej **15,059,295 lekë**, konsideruar si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit*

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Shmangie nga realizimi i procedurës së prokurimit për blerje kompjuterësh dhe pajisjesh, në vlerën prej 1,382,000 lekë.

1.Nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për *blerje kompjuterash dhe pajisjesh të tjera kompjuterike* në shumën totale prej 1,382,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi është pranuar fatura e thjeshtë tatimore e lëshuar nga subjekti privat “S.M.” në vlerën 1,382,000 lekë pa asnjë procedura prokurimi.

2.Ndonëse projekti i kërkimit shkencor është paraqitur nga Departamenti që në muajin qershor të vitit 2016, miratimi për realizimin e fondeve është dhënë më datën 2 dhjetor 2016, pra pas afro 6-muajsh. Mungon bashkëlidhur pagesës vlerësimi i projektit nga Grupi i Vlerësimit të projekteve, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 11 dhe 12 të Udhëzimit të MASH me nr. 19, datë 31.05.2011, “Për detajimin e buxhetit të IAL në programin “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”.

3. Përfitimet e projektit, i shkojnë vetëm autoritetit kontraktor për përdorimin prej tij për çështjet e brendshme, (përndryshe sa ka shkruar Kancelari në shkresën me nr.111, datë 07.12.2016),

4.Mungon ngritja e komisionit për marrjen në dorëzim të këtij projekti, ku të vlerësohej niveli i realizimit të çdo komponenti të tij, si dhe akti i marrjes në dorëzim të projektit si një i tërë; bërja hyrje dhe kontabilizimi i projektit si AQPT. Sa sipër, është vepruar në shkelje të dispozitave të UMF nr.30, datë 2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, por janë bërë hyrje vetëm një pjesë e komponentëve të tij: pajisjet kompjuterike. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/a, faqe 9-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

*Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **1,382,000 lekë**, konsideruar si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit.*

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

Janë kryer për vitet 2016 dhe 2017 pagesat për punë të kryer jashtë kohës normale të saj, prej **712,421 lekë**, në kundërshtim me kuadrin rregullator dhe dispozitat nënligjore në fuqi. Pagesat e kryera nuk janë të justifikuara me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sa vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 463, datë 16.6.2011 "Për disa shtesa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.7.2011 "Mbi zbatimin e VKM nr. 463 datë 16.6.2011", duke krijuar një shpenzim të pa dokumentuar rregullisht. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/a, faqe 9-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

*Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **712,421 lekë**, konsideruar si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit*

6. Gjetje nga auditimi:

Në listën e artikujve të propozuar nga komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimit për periudhën objekt auditimi, rezultojnë disa artikuj dhe vlera materiale (artikuj magazine), të nxjerra jashtë përdorimit në sasi dhe vlerë të konsiderueshme, Referuar procesverbaleve të mbajtura në magazinën e institucionit, rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe asgjësuar 272 copë bojëra printerësh dhe fotokopjesh, me shënimin se këto bojëra janë “tharë”, në vlerën 1,371,491 lekë, për të cilat nuk është kryer asnjë analizë dhe nxjerrje përgjegjësie. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3/a, faqe 9-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Strukturat e drejtimit të Universitetit të analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për **1,371,491 lekë**, konsideruar si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, Nenin 17 të Rregullores së Degëve, Sektorëve dhe Administratës së rektoratit të Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, miratuar me Vendimin nr.13, datë 30.03.2009 të Senatit Akademik, si dhe Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, referuar përshkrimit të punës dhe detyrave që mbulojnë në strukturat përkatëse, kërkoj në bazë të kompetencave Rektorit, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

A. Rektori i Universitetit:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të emrtesës së tij në kuadër të varësisë hierarkike dhe institucionale, referuar pikës 3 të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe mangësive dhe shkeljeve të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” deri në “Largim nga puna”, për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raportin Përfundimtar Auditimi:

1. Z.Gj.P., me detyrë drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit,
2. Znj. O.Th., ish Kryetare e Këshillit Administrativ dhe aktualisht pjesë e stafit akademik të këtij Universiteti.
3. Z. E.S., në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Asgjësimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit (*pasi në bazë të observacioneve konstatohet të jetë pjesë e personelit akademik dhe jo administrativ*)

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

2. AKADEMIA E SHKENCAVE

Nga auditimi i ushtruar në Akademinë e Shkencave, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar” për periudhën 01.01.2017 deri 31.08.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 203, datë 17.12.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1999/6, datë 17.12.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Akademia e Shkencave, **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 muor**³, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë gjithsej **7** rekomandime, nga këto **7** masa organizative.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- g.** Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **7** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht **7**, janë zbatuar **2**, në proces **5**.

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

3. INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nga auditimi i ushtruar në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar*” për periudhën 01.01.2017 deri 31.08.2018, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 163, datë 14.11.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1083/7, datë 14.11.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

-Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 muor**⁴, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse është lënë **1** rekomandim gjithsej, i cili është pranuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a.** Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **1** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht **1**, janë zbatuar **1**.

³ Megjithatë përgjigja është dërguar në KLSH me shkresën nr. 250 Prot. në datën 28.06.2019, duke tejkalluar afatin 6 muor të parashikuar sa më sipër.

⁴ Megjithatë përgjigja është dërguar në KLSH me shkresën nr. Nr. 3393/1 Prot. në datën 01.07.2019, duke tejkalluar afatin 6 muor të parashikuar sa më sipër

4. GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nga auditimi i ushtruar në Gjykatën Administrative të Apelit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar” për periudhën 01.01.2017 deri 31.10.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 187, datë 12.12.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1200/6, datë 12.12.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti, **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit është **kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit është përcjellë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku janë pasqyruar rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre, dhe afatet përkatëse.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **5** rekomandime gjithsej, të cilat janë pranuar plotësisht.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **5** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht **5**, janë zbatuar **2** dhe **3** janë në proces.

Në përfundim **rikërkojmë** nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë që, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

5. DREJTORIA E BORDIT TË UJITJES DHE KULLIMIT DURRËS

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, Durrës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri 31.10.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 173, datë 30.11.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1011/9, datë 30.11.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti, **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **13** rekomandime gjithsej, nga këto 3 masa organizative, 9 masa disiplinore dhe 1 masë për eliminimin e efekteve negative.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **3** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 3, dhe janë zbatuar 3;

- b. Masa për eliminimin e efekteve negative është lënë **1**, e cila është pranuar dhe zbatuar;
- c. Masa disiplinore 9 të cilat janë pranuar dhe zbatuar.

6. UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Nga auditimi i ushtruar në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiarë*” për periudhën 01.01.2017 deri 31.10.2018, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 180, datë 30.11.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1121/7, datë 30.11.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti, **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.**

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 muajor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **5** rekomandime (masa organizative) gjithsej, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.

7. DREJTORIA E BORDIT TË UJITJES DHE KULLIMIT, FIER

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, Fier, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2017 deri 31.8.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 177, datë 30.11.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1011/12, datë 30.11.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti Korçë, **nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.**

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 muajor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë gjithsej, **3** rekomandime (masa organizative), të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.

8. AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Kombëtare (AKBN), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën 01.09.2016 deri 31.07.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 214, datë 19.12.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. . 701/8 datë 20.12.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", subjekti **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor, në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" sipas të cilit është përcjellë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së si dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin tyre dhe afatet përkatëse.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë gjithsej 36 rekomandime, nga këto, 2 propozime për përmirësime ligjore, 25 masa organizative, 1 masë dhe 8 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, janë lënë 2, të cilat janë pranuar plotësisht; nga këto është zbatuar 1 rekomandim dhe është në proces 1.
- b. Masa organizative janë rekomanduar 25, të cilat, janë pranuar plotësisht; nga këto janë zbatuar 9 dhe janë në proces 16;
- c. Masa për shpërblim dëmi janë lënë 1 rekomandime për shumën 157,429 mijë lekë dhe 198,698 USD, i cili është pranuar dhe është në proces zbatimi.
- d. Masa për eliminimin e kostove të tepërta të operacioneve hidrokarbure dhe për të ardhurat e pa hyra në buxhetin e shtetit, janë lënë gjithsej 8 masa në shumën rreth 10,575,579 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 8 rekomandime, janë në proces zbatimi 7 masa në shumën 10,545,979 mijë lekë dhe 1 masë në shumën 29,600 mijë lekë nuk është zbatuar.

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 701/8 datë 20.12.2018, mbi auditimin me objekt "Auditim përputhshmërie", të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, si më poshtë:

A. MASA PËR ELIMINIMIN E KOSTOVE TË TEPËRTA TË OPERACIONEVE HIDROKARBURE DHE PËR TË ARDHURAT E PA HYRA NË BUXHETIN E SHTETIT

5. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi konstatohet se, sipas të dhënave të AKBN për periudhën objekt auditimi 9 subjekte zotërojnë leje me objekt "Shfrytëzim minerali Gips-Alabastër" të cilët kanë prodhuar dhe shitur gjithsej 235,026 ton mineral. Për këtë sasi, renta minerare është llogaritur me tarifën 21 lekë/ton dhe jo e diferencuar sipas raportit që zë "Alabastra" ndaj njësisë së volumit, për të cilën renta minerare është përcaktuar me tarifën 423 lekë m³. Mos llogaritja e kësaj tarife për peshën specifike që zë "Alabastra" ndaj njësisë së volumit sjell të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. Nga verifikimi me zgjedhje i kryer në dokumentacionin e disa subjekteve që zotërojnë leje minerare me objekt shfrytëzimi "Gips-Alabastër", u konstatua:

Subjekti "A." me lejë shfrytëzimi nr. 1433/1, datë 11.09.2009 në zonën Mengaj Kavajë, sipas lejes minerare shfrytëzon mineral "Gips Alabastër" të bardhë me ngjyrë qumështi me përbërje CaSO₄ në masën prej 95.74 % dhe 2H₂O 4.26 %. Ndonëse kjo përqindje e bën mineralin të përshtatshëm për prodhimin e çimentos "Portland" apo të markave të tjera më të larta dhe prodhime të reja (çimento e bardhë), në dokumentacionin që administrohet në dosjen e këtij subjekti nuk u gjenden të dhëna për raportin që zë "Alabastra" në njësinë e volumit të prodhimit të nxjerrë. Nga të dhënat që administrohen në dosjen e monitorimit të këtij subjekti dhe në raportin tekniko-minerar të kësaj zone sipas të dhënave të deklaruara

nga vetë subjekti cilësohet se: *“aktualisht në vendburim (periudha e monitoruar) janë hapur rreth 25,000 ton alabastër”* (cilësim nga vetë subjekti). Përcaktimi i raportit midis mineralit të “Gipsit” dhe “Alabastrës” në raport ndaj njeri tjetrit dhe përqindjes që zënë këto elementë në njësinë e volumit “1 m³” është përcaktues për llogaritjen e rentës së prodhimit të shitur, pasi elementët (gipsi dhe alabastra) sipas ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar kanë rentë të ndryshme. Kështu, në shtojcën nr. 2 të grupit IV “Minerale ndërtimi”, renta minerare për “Gipsin” është 21 lekë/ton dhe për “Alabastrën”, renta minerare është 423 lekë/m³, ose 20 herë më tepër se gipsi. Nga auditimi konstatohet se, vlerësimi i prodhimit të nxjerrë dhe të shitur është bërë me njësi matje të ndryshme e konkretisht, “Gipsi” është vlerësuar me njësinë “Ton” ndërsa “Alabastra” është vlerësuar me njësinë “m³”. Sipas sistemit ndërkombëtar “SI” për të dy këta elementë renta duhet llogaritur në njësi të barabarta ose në ton ose m³, e theksojmë këtë fakt, pasi të dy këta elementë janë pjesë përbërëse e të njëjtit material. Sipas sistemit SI, peshës specifike e mineralit “Gips alabastër” për njësinë e matjes 1 cm³ është e barabartë me 2.2 gram dhe pesha për volumin 1 m³ është e barabartë me 2.2 ton. Nga të dhënat e paraqitura në programin financiar dhe realizimi i treguesve të vitit 2016 konstatohet se, shoqëria ka nxjerrë dhe shitur gjithsej 21.240 ton mineral “Gips alabastër” për të cilën ka llogaritur dhe deklaruar rentë me tarifën 21 lekë/ton në shumën prej 368,421 lekë. Sipas prodhimit të shitur renta në fakt duhej llogaritur në shumën prej 446,040, lekë, ose renta minerare është llogaritur më pak për shumën 77,619 lekë. Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” shtojca nr. 2 renta për mineralin “Alabastër” është përcaktuar me tarifën prej 423 lekë/ton. Nga monitorimi i kryer nga Drejtoria Minerare sipas programit të punës për këtë produkt nuk ka asnjë të dhënë teknike-gjeologjike për raportin që zë alabastra ndaj njësisë ndonëse në rastin konkret alabastra është pjesë përbërëse e mineralin e përbashkët “Gips-Alabastër”. Sipas të dhënave të subjektit në programin financiar si për vitin 2016, 2017 ashtu edhe në miratimin e lejes për periudhën 2018-2019 deklarohet një volum prej 50,000 ton alabastër (respektivisht 25,000 ton çdo vit), e konvertuar në sasinë prej 11,363 m³ (1 cm³=2.2 gr), për këtë volum renta minerare për vitin 2016 duhej të llogaritej në shumën prej 4,806,549 lekë (11,363 * 423), po kështu edhe për vitin pasardhës 2017-2018 renta minerare për “Alabastrën” duhet të llogaritej e veçantë në shumën prej 4,806,549 lekë. Për sa më lart mos llogaritja e rentës minerare për elementin “Alabastër” me tarifën prej 423 lekë/m³, ka sjellë të ardhura të munguara për dy vite në buxhetin e shtetit në shumën prej 9,613,000 lekë. Nga të dhënat e programit financiar të depozituar në AKBN, subjekti ka deklaruar dhe llogaritur koston për njësi të prodhimit të “Gips Alabastër” në shumën prej 200.70 lekë/m³, çmimi i shitjes për këtë mineral është realizuar 950 lekë/m³, me një fitim bruto në shumën prej 750 lekë/m³. Po këto mangësi u konstatuan edhe në subjektin “Inte” që zotëron leje minerali për shfrytëzim “Gips –Alabastër. Për periudhën objekt auditimi 9 subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi “Gips-Alabastër” kanë nxjerrë dhe shitur gjithsej 236,000 ton mineral dhe renta për këtë sasi është llogaritur me tarifën 21 lekë/m³ dhe jo e diferencuar me tarifën prej 423 lekë/ton të përcaktuar në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 9975, datë 20.08.2008, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 60-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5. Rekomandimi:

AKBN, të marrë masa dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë mostra dhe kampione në vend shfrytëzimet e mineralit “Gips Alabastër” me qëllim kryerjen e analizave dhe përcaktimin e raportit që zë Gipsi dhe Alabastra në kampionet që do analizohen me qëllim diferencimin e tarifës për mineralin “Gips” dhe veçimin e mineralit “Alabastër” sipas shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. Nëpërmjet këtij ndryshimi në raportin që zë alabastrin ndaj totalit të mineralit, të ardhurat buxhetore do të rriten në vlerën 29,600,000 lekë (70,000 ton x 423 lekë/ton).

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

9. DREJTORIA E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHËTETIT

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” për periudhën 01.11.2016 deri 31.08.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 245, datë 21.12.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 702/10, datë 22.12.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **nuk ka kthyer përgjigje në KLSH⁵ brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë gjithsej 11 rekomandime, nga këto, 7 masa organizative, 8 masa zhdëmtimi, dhe 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Masa organizative janë janë **7**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 7, janë zbatuar 6, në proces 1.
- Masa për shpërblim dëmi janë lënë **2**, në shumën 729.2 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, nga ku rezultoi në proces zbatimi 1 masë, në vlerën 537.2 mijë lekë dhe e pazbatuar një masë në vlerën 192 mijë lekë.
- Janë lënë **2** masa disiplinore, sipas të cilave Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të rikërkojë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë, të fillojnë procedurat disiplinore për 2 gjyqtarë, nga të cilat 2 masa janë në proces.
- Janë lënë **2** masa për përdorimin e fondeve pa efektivitete, eficiencë dhe ekonomikitet në shumën **55,540 mijë** lekë, nga të cilat pranuar 2, në proces zbatimi 2.

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, **zbatimin** e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 702/10, datë 22.12.2018, mbi auditimin me objekt “*Auditim përputhshmërie*”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA SHPËRBLIM DËMI

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (Kontrata e punimeve, Akt kolaudimi dhe Situacioni Përfundimtar) të objektit “*Ndërtim dhe*

⁵ Me shkresën nr. 1376/1, datë 20.02.2019

Rikonstrukcion i Komisarariatit Special RENEA", Loti I me emërtim "Sistemimet e Jashtme" u konstatua se janë likuiduar, zërat nr. 21, nr. 22 "Dizinfektim + shpëlarje tubi" dhe "Marrje analizash", në kundërshtim me nenin 19 të kontratës, i cili i parashikon që këto zëra punimesh të kryhen me shpenzimet e vet kontraktorit, duke çuar në përfitim të padrejtë të shumës 192,000 lekë nga OE "J" sh.p.k.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **192,000 lekë** gjithsej, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimin, përfituar nga OE "J" sh.p.k.

Menjëherë

b. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të parë të vitit 2019.

10. MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "*Mbi auditimin financiar*" për periudhën 01.01.2017 deri 30.08.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 202, datë 17.12.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1084/5, datë 17.12.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", subjekti **nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 muor**, në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë gjithsej **18** rekomandime (masa organizative).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18** masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht, janë zbatuar 3, në proces zbatimi janë 12 masa, dhe rezultojnë pa zbatuar 3.

I. Në përfundim rikërkojmë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1084/5, datë 17.12.2018, mbi auditimin me objekt "*Auditim Financiar*", të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

4. Gjetje nga auditimi:

Nga Komisioni i Inventarizimit të MTM, i ngritur sipas urdhrit nr. 18, datë 15.11.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm janë nënshkruar rregullisht inventarët e zyrave dhe magazinës në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasi të

fizike të mallrave e materialeve dhe gjendjet kontabile, nga ku nuk kanë rezultuar diferenca. Inventarët e zyrave janë nënshkruar rregullisht nga komisioni dhe personat përgjegjës.

Në relacionin e hartuar evidentohet se nuk janë dorëzuar në magazinë

- Laptop me vlerë 206,525 lekë, në ngarkim të z.D. G. dhe

- Laptop me vlerë 206,525 lekë, në ngarkim të znj.V. B.

Për sa sipër, është vënë shënimi në relacion që *“për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimi duhet te funksionojnë komisionet e tjera të cilat ndjekin procedurat e mëtejshme për materialet e grumbulluara”*

Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit të KLSH rezultoi se:

-Nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura për kthimin e në magazinë dhe të bëhen hyrje në magazinë sipas dispozitave ligjore një Laptop me vlerë 206,525 lekë, në ngarkim të znj.V.B.

-Në librin e debitorëve nuk janë regjistruar detyrimet e mësipërme.

Konkluzioni i grupit të auditimit mbi kryerjet e analizimi i rezultateve të inventarizimit të aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit e asgjësimit të tyre, është se ka mangësi e parregullsi në kryerjen e proceduarve të inventarizimit, pasi nuk janë finalizuar me vlerësimin e pasurisë dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara, nuk janë audituar të drejtat e detyrimet dhe aktivet që janë jashtë ambienteve të Ministrisë (*godina Durrës, pyjet e përfshira në kontabilitetin e këtij institucioni, etj*), në kundërshtim me kërkesat e nenit 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kapitulli V, Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve, Inventarizimi i Aktiveve, pika 74, ku përcaktohet: *“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”*.

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Strukturat drejtuese të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit duhet të forcojnë kontrollin në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionin për vlerësimin e pasurive dhe të procedojnë me nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të dëmtuara, në përputhje me detyrimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në mënyrë që të sigurohen informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që administrojnë

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi nuk kishte rregullore të miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, pavarësisht se është hartuar një draft rregullore (e miratuar me urdhrin nr. 9034 të Ministrit, datë 07.11.2018). Gjendur në këto kushte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kryer aktivitetin e saj duke zbatuar rregulloret e ish ministrive, ish-MM, si dhe ish-ME (për pjesën e turizmit). Pohimi në pyetësorin e vetëvlerësimit me nr. 1580, datë 23.02.2018 për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2017, (pika nr. 8 e pyetësorit, komponenti “Mjedisi i kontrollit”, nënkompenti “strukura organike”, se “Detyrat dhe përgjegjësitë e çdo drejtori/sektori janë të pasqyruara qartësisht në rregulloren e miratuar të ministrive përkatëse, nuk ka raste të mbivendosjes së detyrave dhe përgjegjësisve zyrtare”, nuk përbën fakt të arsyeshëm dhe të vërtetë në pyetësorin e vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm.

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Nga ana e MTM Tiranë të rishikohen komponentët e mjedisit të kontrollit nga ana e të gjithë drejtorive/sektorëve dhe në plotësimin e rubrikave të pyetësorit të vetëvlerësimit të pasqyrohet situata reale e çdo komponenti dhe nënkompenti të lidhur me gjendjen e kontrolleve të brendshme për fazën e raportuar.

14.-Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi rezulton një kosto e madhe nga efektet e vendimeve gjyqësore, për të cilat nuk është nxjerrë përgjegjësia, në kundërshtim me pikën nr. 62, të UMF nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit të shtetit”, sipas të cilit, “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe **kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative**. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.”

Referuar relacionit të bilancit kontabël 2017, del se, duke marrë në konsideratë vendimet gjyqësore të formës së prerë që janë në pritje për tu likuiduar dhe që paraqiten në pasiv të bilancit 2017, **në total janë 399 raste të vendimmarrjes gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, në vlerën totale 377,531 mijë lekë**, nga ku :

Për 140 punonjës janë kryer likuidime në vlerën 120 milionë lekë dhe;

Për 259 punonjës janë depozituar vendimet e formës së prerë (nga këto, 243 punonjës vendim për ekzekutim dhe 16 raste me rikthim në punë).*Për sa sipër, i takon të paguhen rreth 3 persona pothuajse për çdo pozicion të punësuar në institucion.*

Nuk është zbatuar pika nr. 5, e Udhëzimit të KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, që përcakton se: “*Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shyerjes së detyrimit të publikuar*”.

Për sa më sipër, rikërkojmë:

Duke marrë shkas nga vlera e madhe e detyrimeve dhe ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, si për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ashtu dhe për njësitë vartëse, të cilat kanë peshën specifike më të madhe të dëmshpërblimeve nga vendimet e gjykatave, Titullari i Institucionit në respekt të ligjit të menaxhimit financiar, në të ardhmen të analizojë çdo titull ekzekutiv të nxjerrë nga gjykata për largim pa të drejtë nga puna që sjell si pasojë kosto artificiale në shpenzimet buxhetore, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive ndaj zyrtarëve përgjegjës të institucionit.

Në vijimësi

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

11. DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve të Trupit Diplomatik, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2017 deri 30.06.2018, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 132, datë 17.09.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 667/6 datë 17.09.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 6 mujor, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna,

strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë gjithsej **17** rekomandime nga të cilat 7 masa organizative dhe 10 masa për eliminimin e efekteve negative ne administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **7** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 7, dhe janë zbatuar të 7 rekomandimet.
- b. Masa për eliminimin e efekteve negative ne buxhetin e shtetit janë rekomanduar 10, të cilat janë pranuar dhe zbatuar .
- c. Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i është rekomanduar titullarit të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkoj fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore e administrative, për të cilën është shqyrtuar cdo shkelje e konstatuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në vlerësim të Titullarit është **grykuar të mos merret asnjë masë disiplinore ndaj punonjësve.**

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 “Masat disiplinore”, të Kodit të Punës, si dhe Kontratës Individuale të Punës lidhur midis punonjësve dhe Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik i rekomandojmë Drejtorit të DSHTD-s: të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dërguar me shkresën nr. 667/6, datë 17.09.2018 dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore.

12. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Nga auditimi i ushtruar në *Universitetin Bujqësor të Tiranës*, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 131, datë 17.09.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 703/6, datë 17.09.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.**

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **32** rekomandime gjithsej, nga këto 23 masa organizative, 2 masa zhdëmtimi, dhe 7 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **23** masa organizative, nga të cilat nuk është pranuar **1**, janë zbatuar 9, në proces 8 dhe janë pa zbatuar 6 (një).

- b. Masa për shpërblim dëmi janë lënë 2 rekomandime për shumën 2,418 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, dhe janë në proces zbatimi.
- c. Masa për menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondve publike janë dhënë 3, të cilat janë pranuar; nga këto është zbatuar 1 masë, është në proces zbatimi 1 dhe pa zbatuar 1
- d. Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë si dhe Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, i është rekomanduar Rektorit dhe Administratorit të UBT: të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, si dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna” deri në “Largim nga puna” për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë raport përfundimtar auditimi; rekomanduar gjithsej 7 masa, të cilat janë zbatuar plotësisht.

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga Universiteti Bujqësor i Tiranës zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 703/6, datë 17.09.2018, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 211) “Pyje, kullota, plantacione” për vlerën 36,077 mijë lekë i zberthyer në mënyre analitike në 11 objekte.

Nga analiza e zërave të llogarisë 211 rezulton se një pjesë e tyre nuk pasqyrojnë emërtimin, përshkrimin dhe vlerën reale të aktivitetit si më poshtë:

-“Ambient përgjatë rrugës kryesore, fidanishte” në vlerën 1,798,671 lekë, të cilat janë mbjellë në një periudhë mbi tre vjeçare dhe në gjendjen aktuale janë pemë të rritura (Pemëtore).

-“Ish vreshti, Kodër Kamzë” në vlerën 211,484 lekë i cili nuk ekziston më dhe sipërfaqja është zënë me ndërtime.

-“Kopsht botanik, Fidanë” (207 fidanë) në vlerën 64,610 lekë të cilat janë mbjellë në një periudhë mbi tre vjeçare dhe në gjendjen aktuale janë pemë të rritura (Pemëtore).

-“Instituti i Mbrojtjes Bimëve, baza eksperimentale (Vreshti)”, në vlerën 76,780 lekë i cili është i degraduar pasi është mbjellë që në vitin 1978.

-“Ish stacioni i pemëtarisë Tiranë, Fidanë” (hardhi, ulliri, pemë frutore) në vlerën 233,495 lekë të cilat janë mbjellë në një periudhë mbi tre vjeçare dhe në gjendjen aktuale janë pemë të rritura (Pemëtore).

UBT duhet të hartojë dokumentacionin përkatës, planimetritë për sipërfaqet e tokave, hartat topografike të përshtatë statusin e aktiveve dhe rivlerësojë ato bazuar në gjendjen aktuale të tyre, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga UBT të merren masa që gjatë planifikimit të shpenzimeve për periudhat e ardhshme të planifikojë një zë për shpenzimet që do të nevojiten për të bërë rivlerësimin e aktiveve (Pyje, kullota, plantacione). Rivlerësimet të kryhet në mënyrë të rregullt dhe të mjaftueshme, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohet nëse do të përdoret vlera e drejtë në datën e bilancit. Vlera e drejtë e pemëve, pemëtoreve, vreshtave, plantacioneve nëpërmjet hartimit të dokumentacionit përkatës, planimetrive për sipërfaqet e tokave, hartat topografike,

përshatja e statusit të aktiveve duhet të përcaktohet nga evidenca e bazuar në treg nëpërmjet një vlerësimi që ndërmerret nga vlerësues profesionistë të kualifikuar e të pavarur.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar” janë të pasqyruara (llog. 202) “studime dhe kërkime” në vlerën 12,654,004 lekë i zbërthyer në mënyre analitike në këto nënzëra.

-Studime dhe kërkime në vlerën 12,515,804 lekë vlerë e pa përcaktuar se kush janë këto studime dhe kërkime.

- Dhënie “license nga ISHP”: në vlerën 20,000 lekë,

- “Rilevim dhe përpilim i planit topografik të territorit të UBT- së” në vlerën 118,200 lekë, më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Nga UBT, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve “studime dhe kërkime”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme të Pa Trupëzuara:

-Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të UBT-së, për vitin 2018.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: “Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët” (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formatin nr. 2 për vlerën 216,650 mijë lekë detyrime ku:

a. (llog. 411-418) “Klientë e llogari të ngjashme” zënë shumën 3,339 mijë lekë, Në analizë këta klientë përbëhen nga 16 subjekte për detyrim qira për objekte dhe shitje produktesh. Klientë të krijuar kryesisht në vitet 2016 dhe 2017. Klienti A.K.(Shoqëria F..) ka detyrimin prej 1,007,118 lekë për kontratë shitje misër e krijuar nga viti 2004 dhe e pa arkëtuar. Gjithashtu edhe klienti “D.. T...S..” me vlerën 4,750 lekë për shitje qumësht e krijuar në vitin 2005 - 2006 e pa arkëtuar. “Q... Pol..” për detyrimin prej 6,000 lekë e krijuar nga viti 2008 e pa arkëtuar. (Nga totali i detyrimit vlera prej 1,018 mijë lekë është pa shpresë arkëtimi).

b. (Llog. 468) “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 54,300 mijë lekë e cila në analizë përbëhet nga 16 debitorë ku 7 debitorë me vlerën 46,370 mijë lekë janë debitorë të një periudhe mbi 8 vjeçare para vitit 2010. (Nga kjo vlera prej 43,053 mijë lekë e cila përbëhet nga shuma e të ardhurave të konstatuara për tarifën e shkollimit të studentëve që nuk kanë frekuentuar shkollën për vitet 2007-2008 dhe 2008-2009 është konsideruar pa shpresë arkëtimi), më hollësisht trajtuar në, faqet 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Drejtuesit e UBT-së duhet të sigurojë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

Nga organet Drejtuese të UBT-së të rivlerësohen llogaritë e njësisë ekonomike për shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në Universitetin Bujqësor, Tiranë (UBT), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme. NJP-ja ka shumë përgjegjësi sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte

si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së, më hollësisht trajtuar në faqet 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

UBT, në varësi të burimeve njerëzore që ka në dispozicion të shikojë mundësinë, për të ngritur funksionimin e strukturës së posaçme të prokurimit publik, e kjo në zbatim të nenit 57 “Njësia e Prokurimit” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim edhe të sigurimit të mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale duke rritur eficientësinë, ekonomikitetin dhe efektivitetin në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontabilitetit rezultoi debitorë në shumën **94,596 lekë** punonjësja J.L. në vitin 2000, pikë shitje për libra shkollorë, shumë e cila pretendohet të jetë derdhur nga punonjësja po në vitin 2000, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit është mbajtur dhe regjistruar në librat përkatës debitorë dhe shuma për tu shlyer, pa ndjekur procedurat ligjore për vërtetimin nëse ky arkëtim është kryer ose jo, më hollësisht trajtuar në faqet 72-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **94 596 leke** pikë shitje për libra shkollorë, shumë e cila pretendohet të jetë derdhur nga punonjësja J.L. në vitin 2000 dhe është lënë e pa sistemuar nga ana kontabël, nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua së në dy raste, në vitin 2012 dhe vitin 2013, administrata e Rektoratit nga të ardhurat e UBT, ka shpërblyer në vlerën neto 1,416,911 lekë punonjësit e saj, pasi janë angazhuar si drejtues të zyrave ndihmëse të Rektoratit, dhe si të tillë kanë bërë të mundur funksionimin normal dhe me eficientësi të plotë të zyrave që ata drejtojnë duke qenë njëkohësisht edhe pedagogë me ngarkesë të plotë, duke përdorur si referencë ligjore VKM nr.720, datë 29.11.1995, “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera detyrësore shtetërore”, vendim i cili më 01.06.2012 është shfuqizuar me VKM nr. 418, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore”, më hollësisht trajtuar në faqet 72-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga UBT të merren të gjithë masat e duhura ligjore për shpërblimin e dëmit prej **1,416,911 lekë** nga 8 punonjësit e institucionit, si përfitim të padrejtë.

Menjëherë

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

28. Gjetje nga auditimi: Për tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i objekteve të UBT, 2017”, me urdhrin nr. 12, dt. 21.07.2017 është ngritur grupi i punës për argumentimin e fondit limit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit për kryerjen e rikonstruksionit të objekteve ndërtimore për UBT për vitin 2017. Ky grup pune me shkresën nr. 1488/1, dt. 21.07.2017 ka përgatitur preventivin me zërat e punimeve me sasi të përkatëse pa çmimet për njësi dhe vlerat përkatëse pa përcaktuar fondin limit për rikonstruksionin e objekteve ndërtimore në UBT megjithëse ky komision shprehet se fondi limit është **15,719,666 lekë** pa tvsh. Gjithashtu nuk ka një projekt të hartuar me planimetritë përkatëse për punimet për çdo objekt që do të ri konstruktohej mbi bazën e të cilit do të dilnin edhe zërat e punimeve.

- Sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 914, dt. 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, pika 2, Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

“përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme”; “përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme”;

- Është vepruar në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar:

- pika 3.1, “Preventivat e objekteve të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave”..... . “Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv”.

- kreu 1, pika 4 dhe 5, sipas të cilave: Personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit janë: investitori; sipërmarrësi; mbikëqyrësi i punimeve. Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm: c) Projektin e zbatimit të firmosur nga projektuesi

Projekti i zbatimit përmban:projektin e plotë konstruktiv, së bashku me relacionin teknik shpjegues;..... Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit

më hollësisht trajtuar në, faqet 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

UBT, të marrin masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **15,719,666** lekë.

Menjëherë

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

13. SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Universitar të Traumës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 54, datë 21.06.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 68/7, datë 22.06.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit është **kthyer përgjigja brenda afatit 6 muhor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit është përcjellë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse për zbatimin e tyre.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **39** rekomandime gjithsej, nga këto 25 masa organizative, 5 masa zhvenditimi, 5 masa disiplinore, dhe 4 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **25** masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar 16, dhe janë në proces 9.
- b. Masa për shpërblim dëmi janë lënë 5 rekomandime për shumën 20,755 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, zbatuar 1 masë në shumën 90 mijë lekë, dhe në proces zbatimi 4 masa në shumën 20,665 mijë lekë.
- c. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë gjithsej **4 masa në shumën totale prej 9,482 mijë lekë**, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë në proces zbatimi;
- d. Masa disiplinore janë lënë gjithsej 5, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht

I. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

14. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2017 deri 31.08.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 209, datë 17.12.2019, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1011/17, datë 19.12.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, subjekti **nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **23** rekomandime gjithsej, nga këto, 2 propozime për përmirësime ligjore, 19 masa organizative, 1 masë zhdëmtimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Masa organizative janë lënë **19**, të cilat janë pranuar plotësisht; nga këto janë zbatuar 11, në proces zbatimi janë 5, janë zbatuar pjesërisht 2, dhe rezultoi e pa zbatuar 1;
- b. Propozim për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, janë lënë **2** rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht; nga këto **1** rekomandim është në proces zbatimi dhe **1** rekomandim është i zbatuar;
- c. Masa për shpërblim dëmi është lënë **1** rekomandim, në shumën 69,998 mijë lekë, i cili pranuar pjesërisht dhe është në proces zbatimi.
- d. Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i është rekomanduar titullarit të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkoj fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore e administrative.

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga *Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. nr. 1011/17, datë 19.12.2018, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

13. Gjetje: Nga auditimi i prokurimeve rezultoi se në pikën 2.3 Kapaciteti teknik të Dokumentet e Tenderit të procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje kafshë të llojit gjedh për dëmshpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga dermatozat nodulare e gjedhit, i ndarë në Lotë*”, me fond limit Loti I “*Blerje kafshë të llojit gjedhë për zonat kodrinore malore*” në vlerën 191,103,096 lekë pa tvsh dhe Loti II “*Blerje kafshë të llojit gjedhë për zonat ulëta fushore*” në vlerën 51,320,000 lekë pa tvsh realizuar në vitin 2017, njësia e prokurimit ka kërkuar dhe vendosur që ofertuesi të paraqes një deklaratë “..... që do dorëzojë mallin pranë Drejtorive të Bujqësisë në Qarqe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor”, por pa sqaruar se cilat janë kërkesat specifike, për strehimin e gjesë së gjallë në ambientet të përshtatshme deri sa të realizohet shpërndarja e tyre tek fermerët të cilët kanë humbur gjënë e gjallë, në përputhje kjo me dokumentat shoqeruese të përcaktuara në VKM nr.408, datë 08.05.2013 “Për shpërblimin për kafshët e eliminuara” i ndryshuar me VKM nr.945, datë 28.12.2016. Veprim ky në kundërshtim me VKM e sipërcituar dhe me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 (specifikimet teknike).

b. Gjetje: *Monitorimet e kontratave të furnizimit si për Lotin e I dhe për Lotin e II si dhe dokumentimi i pagesave për furnizuesin*, nuk janë bërë me transparencë dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar, pasi mungon ekzistenca e Komisionit të Mbikëqyrjes së kontratës, për të dokumentuar aktivitetin e dëmshpërblimit të gjedhit të gjallë. AK është bazuar vetëm në dy procesverbalet të marrjes në dorëzim nga MBZHR dhe procesverbalit të dorëzimit të gjedhit nga MBZHR në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe faturat tatimore të shitjes të lëshuara nga operatori fitues “N.F.” shpk (N) me ofertë ekonomike në vlerën prej 190,836,000 lekë pa tvsh për Loti I dhe për Loti II lëshuara nga operatori fitues “N.F.” shpk (N) me ofertë ekonomike në vlerën prej 51,320,000 lekë pa TVSH . Por, në zbatim të VKM nr.408, datë 08.05.2013 “Për shpërblimin për kafshët e eliminuara” i ndryshuar, në dosjen fizike të administruar nga AK (sektori i prokurimeve dhe sektori i financës) nuk ndodhet asnjë relacion përfundimtar mbi shpërndarjen tek përfituesit, për të vërtetuar numri e saktë të fermerëve përfitues nëpër qarqe të ndryshme të vendit. Po kështu, pagesat e bëra për operatorin fitues “N.F.” shpk (N), me disa Urdhër shpenzime, konkretisht me nr: 184,186,187,188, 206,209 dhe 216 të muajit qershor 2017 dhe nr. 236 dhe 254 të muajit korrit 2017, nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin ligjor dhe financiar, për dorëzimin e gjesë së gjallë në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, si dhe nuk janë të shoqëruara me listat emërore të fermerëve përfitues. Këto veprime bie në kundërshtim me, Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me neni 77, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të ngrihet grup pune për të kryer inspektimin e dokumentacionit vërtetues ligjor dhe financiar, pranë Drejtorive të Bujqësisë në qarqet përfitues për dëmshpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga dermatozat nodulare e gjedhit për vitin 2017 , me qëllim që të bëhet e mundur pasqyrimi me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të shpenzuar në këtë procedurë prokuruese.

14. Gjetje: Procedura prokurimit me objekt “Shpenzime mbrojtje e ullishte në bllok nga miza e ullirit në zonat prioritare të prodhimit, qarqet Elbasan, Fier, Vlorë, Tiranë, Lezhë dhe Berat, me fond limit në vlerën 111,138,682 lekë pa tvsh me “procedurë e hapur”, të zhvilluar në vitin 2017 sipas Urdhër prokurimi nr. 247, datë 06.06.2017 është anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës. Konkretisht, në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, “B”, “L” shpk & D.M.(Person Fizik) & F.M. (Person Fizik). Por, KVO-ja me të drejtë e ka skualifikuar këtë “B”, sepse sipas Kontratës së bashkëpunimit me nr. 865 datë 29.06.2017, këto dy operatorët ekonomikë, kanë përcaktuar pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi, vetëm për përqindjen e pjesëmarrjes së shërbimit dhe nuk kanë përcaktuar elementët konkretë të shërbimit që do të marrin përsipër të realizojnë.

Kjo procedurë është zhvilluar përsëri sipas Urdhëri Prokurimit nr.364, datë 23.08.2017 me fond limit 168,547,182 lekë pa tvsh, por këtë herë “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Mirëpo u konstatua se, *AK nuk e ka të argumentuar dhe të arsyetuar përzgjedhjen e kësaj procedure sipas kërkesave të nenin 33 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe me nenin 36 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Po kështu, procedura e dytë “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” është zhvilluar me fond limit me vlerë më të lartë se procedura e parë, konkretisht nga 111,138,682 lekë pa tvsh që ishte në procedurën e anuluar është rritur në vlerën 168,547,182 lekë pa tvsh, pra 57,408,500 lekë pa tvsh më tepër. Shtimi i fondit limit sipas Memo datë 21.08.2017 drejtuar Ministrit nga sektori i prokurimeve dhe ish-sekretari i përgjithshëm, është bërë me këtë argumentin se është shtuar numri i qarqeve të prekura (pra sipërfaqet), ndërsa përcaktimi i procedurës me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është realizuar në kundërshtim me neni 36, pika 2/a, të VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sepse :

Së pari në fillim viti AK (MBZHR) përgatit regjistrin e parashikimeve për procedurat tenderuese, në bazë të kërkesave nga Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, nisur nga fakti se insekti “miza e ullirit” është evident ku zhvillohet kokrra e ullirit për çdo vit;

Së dyti në bazë të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve” i ndryshuar, neni 13, ka parashikuar që në buxhetin vjetor të ministrisë të planifikohen “fonde të veçanta për mbrojtjen e bimëve”, këtij fakti i referohet dhe Urdhri i Ministrit nr. 113, datë 28.03.2017 “Për caktimin e parazitëve të veçantë në bujqësi për vitin 2017”:

Së treti, meshkresë nr. 3606/2 prot, datë 02.05.2017, ku i është kërkuar Ministrisë së Financave, transferimi i këtij fondi nga artikulli 606 në artikullin 602, me arsyetimin që ky fond do të përdoret për realizimin e shërbimit “Mbrojtja e ullishtave nga dëmtimi i mizës së ullirit në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit;

Së katërti, nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka startuar procedura e prokurimit me objekt “Mbrojtja e ullishtave nga dëmtimi i mizës së ullirit në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit”, por nuk ka përfunduar (përgjatë auditimit nuk është paraqitur asnjë arsyetim për mos realizimin e saj).

Për sa më sipër, del qartë se, përzgjedhja e procedurës me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” nga AK me arsyetimin e krijimit të emergjencës nuk është e argumentuar dhe e justifikuar në përputhje me kërkesat e bazës ligjore të sipërcituara. Në kushtet e anulimit të tenderit të parë, AK duhet të nxirrte arsyet e anulimit dhe nëse mungesa e konkurrencës kishte ardhur për gabime në hartimin e DT, pra për faj të vetë AK, duhet të nxirreshin përgjegjësit përkatëse, të korrigjoheshin DT dhe të filloheshin menjëherë përsëri procedurën e tenderit të hapur. Dhe në raste të anulimit të procedurës së dytë për shkaqe objektive, pra të mungesës së konkurrencës atëherë duhet të zhvillonte procedurën e trete me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Gjithashtu, në procedurën me negociim janë ftuar të marrin pjesë tre operatore dhe ka marrë pjesë vetëm 1(një) bashkim operatorësh “G. ..Grup”shpk & “A. I.”shpk me oferte

në vlerën 167,987,180 lekë pa tvsh, i cili është shpallur fitues. Nga auditimi u konstatua se ky bashkimi i operatorëve ekonomikë fitues, sipas Marrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë me nr. 4935, nr. 1753, datë 28.08.2017 dhe kontratës së bashkëpunimit me nr. 865 datë 29.06.2017, e kanë ndarë këtë kontratë shërbimi vetëm në %, respektivisht, operatori “G...Grup” ka marrë përsipër të realizojë 20% të vlerës së kësaj kontrate dhe operatori tjetër “A.I.” do të realizojë 80% të saj. Mirëpo, në kontratën e bashkëpunimit nuk kanë të ndarë dhe të përcaktuar elementët konkretë të realizimit të këtij shërbimi, se çfarë shërbimi apo furnizime konkrete përfaqësojnë këto përqindje për secilin operatorë që do ti realizojë kontratën.

Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 2, për pasojë ky bashkim operatorësh duhej të skualifikohej dhe jo të shpallej fitues.

Sa më sipër duket qartë se, KVO-ja, ka vepruar me dy standarte, sepse nga njera anë në procedurën (I) e anuluar me të drejtë ka skualifikuar bashkimin e OE, “L” shpk & D.M & F.M., pasi sipas Kontratës së bashkëpunimit nr. 865 datë 29.06.2017, operatorët ekonomikë, kanë përcaktuar pjesëmarrjen, vetëm në përqindjen e vlerës së shërbimit dhe pa përcaktuar elementët konkretë të shërbimit që do të realizonin, ndërsa nga ana tjetër në procedurën me negociim kanë kualifikuar dhe shpallur fitues bashkimin operatorëve ekonomikë “G...Grup”shpk & “A.I.” i cili dhe ky kishte paraqitur Kontratën e bashkëpunimit pa përcaktuar elementët konkretë të shërbimit që do të realizonin, por vetëm vlerën e shërbimit të shprehur në përqindje.

- Nga auditimi, në lidhje me monitorimin e Kontratës së Shërbimi nr.6409, datë 31.08.2017 u vërejt se, nga pikëpamja formale, hartimi i kontratës ka mangësi në “termat e referencës” pasi sipërfaqet që do të trajtohen janë shprehur vetëm në njësi matëse (në Ha) në bazë qarqesh. Ato nuk janë detajuar edhe mbi bazë njësie administrative të ndara sipas fshatrave dhe pse një informacion i tillë administrohet paraprakisht nga MBZHAU, pasi këto të dhëna dërgohen si kërkesa nga Drejtoritë e Bujqësive Rajonale të Qarqeve, për llogaritjen e fondit limit. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006”për prokurimin publik” neni 23.

-Nga Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë në zbatim të nenit 4, pika 4-3, nuk janë përcaktuar ambientet për magazinimin nga ana e të “kontraktuarit” të preparatit të PMB që nevojitet jo më vonë se 2 (dy) ditë para fillimit të trajtimit. Kushti i vendosur në kontratë bie ndesh me VKM nr.1188, datë 20.08.2008 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve” në të përcaktohen qartë rregullat për magazinim këtyre produkteve si dhe me pikën 5.3 “Specifikimet teknike”.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të nenit 79 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të njoftoj Agjencinë e prokurimit publik për marrjen e masa administrative ndaj anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe anëtarët e KVO, për mosrespektimin e rregullave të prokurimit, të trajtuar më sipër dhe më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit.

Menjëherë

15.Gjetje: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje e vaksinës për luftimin e sëmundjes së dermatozës nodulare të gjedhit (limpy skin”, me fond limit në vlerën prej 122,759,000 lekë pa tvsh, realizuar në vitin 2017 me fitues operatorin “A...” shpk me vlerë fituese prej 122,700,000 lekë pa tvsh,u konstatua se, monitorimi i kontratës Furnizimi nr. 4817, datë 19.06.2017 dhe dokumentimi i pagesave, nuk është bërë me transparencë dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar. Nuk është ngritur Komisioni i Mbikëqyrjes së kontratës, për të dokumentuar të gjithë aktivitetin e realizimit të procesit të vaksinimit të gjedhëve. AK është bazuar vetëm në faturën tatimore të shitjes të lëshuara nga operatori fitues “A...” shpk, për likuidimin financiar në drejtim të operatorit

ekonomik fitues. Në dosjen fizike e administruar nga AK (sektori i prokurimeve dhe sektori i financës) nuk ndodhet asnjë relacion përfundimtar mbi shpërndarjen tek përfituesit (numri fermerëve përfitues nëpër qarqe të ndryshme të vendit, të cilët përfituar nga vaksinimi, kundër sëmundjes së Dermatozës Nodulare (Lumpy Skin Disease.) Po kështu edhe Urdhër shpenzimi nr.260 datë 03.08.2017, për pagesën e operatorit fitues “A” nuk është shoqëruar me dokumentacionit justifikues ligjor dhe financiar, të marrjes në dorëzim të vaksinës nga Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, si dhe nuk figurojnë listat emrore të blegtorëve përfitues. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 77, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me pikat 35/ b dhe 36 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Për sa më sipër rikërkojmë:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të ngrihet grup pune për të kryer inspektimin e dokumentacionit vërtetues ligjor dhe financiar, pranë Drejtorive të Bujqësisë në qarqet përfituese për vaksinën për luftimin e sëmundjes së dermatozës nodulare të gjedhit (limpy skin), me qëllim që të bëhet e mundur pasqyrimi me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të shpenzuar në këtë procedurë prokuruese.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” i ndryshuar, **i rikërkojmë** Ministrin të MBZHR: Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil” për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

15. SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNESIMIT

Nga auditimi i ushtruar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2016 deri 31.03.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 151, datë 29.09.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 679/7, datë 03.10.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit është **kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit është përcjellë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet respektive.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **15** rekomandime gjithsej, nga këto, 1 propozim për përmirësim ligjor, 12 masa organizative, dhe 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Masa për Përmirësimin Ligjor është lënë **1** e cila, është pranuar dhe zbatuar plotësisht;
- b. Masa Organizative janë lënë **12**, nga të cilat janë pranuar 11, zbatuar 7, në proces zbatimi 4 janë në proces, dhe 1 masë rezultoi e papranuar;
- c. Masa për menaxhimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë gjithsej **2**, në shumën 2,469 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht; nga këto 1 masë është zbatuar, dhe 1 e pazbatuar.

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga *Shërbimin Kombëtar të Punesimit* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. me shkresën nr. 679/7, datë 03.10.2018, mbi auditimin me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

6. Gjetje nga auditimi:

Në aktivin e bilancit kontabël llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është paraqitur në vlerën zero lekë. Përsa më lart rezulton se nuk janë regjistruar në kontabilitetin e institucionit, detyrimet për llogarinë 468 “*Debitor në persona*”, në vlerën e përgjithshme prej 1,007,500 lekë, referuar konkluzioneve të auditimit të dërguara nga ana e KLSH sipas shkresës nr. 1135/10 prot, datë 29.06.2016, ku është përcaktuar detyrimi që të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit për vlerën 1,007,500 lekë. *Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rikërkojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e SHKP të marrë masat për analizimin dhe ndjekjen e procedurave për vënien në kushtet e arkëtimit të shumës prej 1,007,500 lekë, si dhe të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH, rezulton se nuk janë arkëtuar detyrimet në vlerën 1,007,500 lekë, nga punonjës, të cilët kanë një detyrim të caktuar ndaj institucionit, krijuar nga auditimi i ushtruar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit (shkresa nr. 1135/12, datë 04.07.2016). Kështu, janë 31 persona/subjekte debitorë ndaj SHKP, dhe në lidhje me këto detyrime institucioni nuk i ka pranuar si detyrime, nuk i ka regjistruar ato dhe nuk ka mundur të arkëtojë këto vlera detyrimesh të krijuara nga viti 2014-2015, por institucioni nuk ka politika të qarta për arkëtimin dhe menaxhimin e debitorëve, siç përcaktohet në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Shërbimi Kombëtar i Punësimit të analizojë dhe rivendosë në afat procedurat për të mundësuar vënien në kushte arkëtimi të detyrimeve të krijuara nga raportet e auditimit të ushtruar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Spektori i Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa, që të analizojnë situatën e këtyre detyrimeve dhe të hartojnë një planveprimi për zgjidhjen e situatave të krijuara dhe të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve.

Menjëherë

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

16. AVOKATURA E SHTETIT

Nga auditimi i ushtruar në Avokaturën e Shtetit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 95, datë 30.07.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 219/8, datë 08.08.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 muajor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **25** rekomandime gjithsej, nga këto, 2 propozime për përmirësime ligjore, 16 masa organizative, 3 masa zhdëmtimi, dhe masa për eliminimin e fekteve negative në administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Propozime për përmirësime ligjore janë lënë **2** rekomandime, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **16** masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht **15**, në proces zbatimi **1**.
- c) Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë **3** rekomandime për shumën 143 mijë lekë dhe 385 euro nga të cilat, janë pranuar **3**, janë në proces zbatimi **2**, dhe është zbatuar **1** masë në shumën 111,888 lekë.
- d) Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë **2** rekomandime, të cilat janë pranuar dhe zbatuar.
- e) Rekomandime të ardhura të munguara në dëm të buxhetit të shtetit janë lënë **2** rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi.
- f) Mbështetur në nenin 31 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i është rekomanduar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, të vlerësojë, në

varësi të analizës së përgjegjëse, shkallën e përgjegjësisë për secilin nëpunës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloj procedurat për dhënien e masave disiplinore e administrative.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, inkurajojmë angazhimin maksimal nga ana e subjektit dhe përsheptimin e procesit deri në zbatimin e plotë të rekomandimit të mëposhtëm:

A. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË DËM TË BUXHETIT TË SHTETIT

Gjetje 1. Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH (me shkresë të KLSH me nr.264/8, datë 12.10.2015), në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “V.E.P. Ltd” për procedurën e zhvilluar për privatizimin e shoqërisë “A.” sha, Patos”, KLSH ka rekomanduar: “*Të vazhdojë me përparësi ndjekja e procedurave ligjore brenda dhe jashtë vendit, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim të ngushtë me Avokaturën e Shtetit, për të mundësuar arkëtimin e kësaj shume, duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet rrjedhojë e këtij procesi.*”

Nga verifikimi pranë Avokaturës së Shtetit mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, rezultoi se midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-(MZHETTS), sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur korrespondencë në lidhje me këtë problematikë, sikurse shkresat me nr. 8276/2, datë 30.10.2015, me nr. 8291/2, datë 20.11.2015, nr. 2564/1 datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, mirëpo në to Avokatura e Shtetit ka kërkuar thjesht marrje informacioni mbi dosjen e privatizimit të “A.” sh.a, dhe nuk ka këmbëngulur të dijë mbi ecurinë për të përsheptuar dhe mundësuar nga ana ligjore arkëtimin e garancisë së ofertës.

Institucioni i Avokaturës së Shtetit ka pasur dijeni për *mos arkëtimin e garancisë së privatizimit, në vlerën prej 85 milionë Euro nga kompania “V.E.P.Ltd”* që nga viti 2012. Deri tani, ky institucion, ende nuk ka marrë asnjë veprim ligjor, në bashkëpunim me ish- METE, ish-MZHETTS, tashmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arkëtimin e kësaj vlere, në bazë të ligjit 10018 “Për Avokaturën e Shtetit” datë 13.11.2008 neni 5 pika 1 germa “ë”.

Gjithashtu, Avokatura e Shtetit me shkresa zyrtare, duhej të kishte sensibilizuar dhe tërhequr vëmendjen, që strukturat e larta shtetërore të përfshira në këtë çështje, të mos humbnin kohë, duke iu propozuar atyre mundësitë ligjore për arkëtimin e garancisë së ofertës të paraqitur nga kompania “V.E.P.Ltd”. Kjo mënyrë veprimi nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë tejkalimin e të gjitha afateve procedurale deri në atë fazë që çështja të kalojë në heshtje dhe të bëhet e pakërkuar, me justifikimin e artificave procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar.

Rekomandimi:

Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mosveprimin me qëllim arkëtimin e të ardhurave në favor të buxhetit *në vlerën 85 milionë Euro*, si dhe të investohet tërësisht dhe urgjentisht në këtë çështje.

Menjëherë

B. TË TJERA.

1. Për të gjitha rekomandimet e tjera që konsiderohen në proces zbatimi, ose të zbatuara pjesërisht të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2019.

Pavarësisht auditimit që ne kemi kryer për zbatimin e rekomandimeve, ju kujtojmë që në mbështetje të nenit 15 germa “j” të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, jeni të detyruar që brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve tona.

17. INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Nga auditimi i ushtruar në Institutin e Shëndetit Publik për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar”, për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 94, datë 30.07.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 544/6, datë 30.07.2018, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

Nga ana e subjektit nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë gjithsej **17** rekomandime (masa organizative).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **17** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 17, janë zbatuar 13 dhe në proces 4.
- b. Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, i është rekomanduar Drejtorit të ISHP të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore

I. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë, të vitit 2019, veçanërisht vlerësimi nga Drejtori i ISHP-së mbi shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 544/6, datë 30.07.2018, në varësi të analizës së përgjegjësive, duke kërkuar fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore

18. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar”, për periudhën 01.01.2016 deri 31.08.2018, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 179, datë 30.11.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1051/7, datë 30.12.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti nuk ka kthyer

përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë 4 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, zbatuar 1 masë dhe në proces zbatimi 3.

I. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë, të vitit 2019.

19. MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS E ENERGJISË

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin financiar”, për periudhën 01.09.2017 deri 31.08.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 172, datë 30.11.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1010/6, datë 30.11.2018, konstatohet se:

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.**

- Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **22** rekomandime gjithsej, nga këto, 22 masa organizative.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej **22** masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht; nga këto është zbatuar **1**, është në proces zbatimi **1** dhe **20** masa rezultuan të pa zbatuara.

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1010/6, datë 30.11.2018, mbi auditimin me objekt “Auditim financiar”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në formatin nr. 1, Zëri “Ndërtim e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 549,084 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike. (Inventari përbëhet nga 21 objekte në vlerën 549,083,943 lekë). Si shihet nga

inventari i zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) në këtë zë janë përfshirë dhe objektet me vlerën 167,418,415 lekë si më poshtë:

- Dyer Copë 2 në vlerën 189,124 lekë;
- Rikonstruksion godine në vlerën 3,810,913 lekë;
- Instituti i ndërtimit-oponencë (m940077) në vlerën 573,724 lekë;
- Analiza gjendjes godinës (m940055) në vlerën 16,902,000 lekë.
- Derë jashtë duralumini me veshje adezive në vlerën 99,976 lekë;
- Rikonstruksioni i godinës në vlerën 145,516,374 lekë;
- Mbikëqyrje punimesh pjesor sist. ngrohje ftohje m 064038 në vlerën 326,304 lekë.

Në këtë rast shpenzimet për investimet sipas zërave përkatëse duhej të kalonin duke shtuar vlerat e inventarit të atyre objekteve për të cilat është kryer studimi ose rikonstruksioni përkatës, gjithashtu edhe mbikëqyrja e punimeve.

Mbajtja e këtyre si zë inventari të “Ndërtime e konstruksione” në vlerën 167,418,415 lekë është e pa saktë dhe denatyrton llogarinë e aktiveve afatgjata (Në rastin e studimeve këto vlera mund të mbaheshin në llogarinë 202 “Studime e kërkime” dhe në përfundim të investimit ti shtoheshin vlerës së investimit për të cilin është kryer ky studim)

-Nga auditimi rezultoi se zëri “Rrugë rrjete, vepra ujore” (llog. 213) në vlerën 11,782 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike ku përfshihet në inventar edhe “Rikonstruksion rrjeti” në vlerën 213,600 lekë, i cili nuk duhet të paraqitet si inventar më vete por duhet të shtojë vlerën e aktivitetit të ri konstruktuar.

-Në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar” në vlerën 588,215 mijë janë të pasqyruara sipas zërave “studime dhe kërkime” ku janë përfshirë edhe aktivitetet e papërcaktuar në vlerën 62,094,745 lekë si më poshtë:

- Studime MIE para vitit 2014 në vlerën 3,687,060 lekë.
- Studime të viteve të kaluara MTI në vlerën 33,337,685 lekë.
- Studime MTI 2017 në vlerën 25,072,000 lekë.

Në këtë rast vlerat për studimet dhe kërkimet nuk janë të specifikuar të cilat në përfundim të investimit mund të shtoheshin vlerës së investimeve për të cilat është kryer studimet. Në inventarizimin e aktiveve zëri “studime dhe kërkime” nuk është përfshirë dhe nuk është realizuar inventarizimi i tyre.

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Nga MIE, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve “Ndërtime e konstruksione” dhe “Rrugë rrjete, vepra ujore”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve të Afatgjata Materiale:

-Nga MIE, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve “studime dhe kërkime”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve të Afatgjata jo materiale:

-Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të MIE, për vitin 2018.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kartelës së llogarisë 209 dhe 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor (62,726 mijë lekë) është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:

Llog. nr. 2092 “Amortizim studime dhe kërkime” = 3,068 mijë lekë (Në analizë është llogaritur për 3,147 mijë lekë). Sa më sipër nuk ka gjetur zbatim SKK nr. 5 të përmirësuar; *“Një njësi ekonomike duhet të shpërndajë shumën e amortizueshme të një aktivi jomaterial në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Amortizimi për çdo periudhë do të njihet si një shpenzim, përveç nëse një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e kostos së një aktivi tjetër”*.

- Amortizimi vjetor i Aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në formatin 7 është në vlerën 59,657,843 lekë kurse në analizë sipas zërave vlera është 63,581,983 lekë me një diferencë prej 3,924,140 lekë si më poshtë:

Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 107, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, *“Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale”*, i përmirësuar, ku përcaktohet se: *“Amortizimi është konstatimi kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezulton nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të pakthyeshme (përfundimtare) për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre.*

Paragrafit nr. 107: *“Shpenzimet e amortizimit të AAM-ve dhe AAJM-ve, si dhe humbjet nga zhvlerësimi, paraqiten si zë më vete i formatit 1 të pasqyrës së performancës, si dhe në zërat përkatës të formatit 2, në varësi të funksioneve të aktiveve në njësinë ekonomike. Fitimet/humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të AAM dhe AAJM njihen në zërat “Shpenzime të tjera të shfrytëzimit”*.

“Amortizimi i AAGJ-së” është shpërndarja periodike dhe sistematike e vlerës së amortizueshme të AQT apo AP, në përputhje me jetëgjatësinë e dobishme. Jeta e dobishme ka të bëjë me periudhën gjatë të cilit ky lloj aktivi pritet të përdoret nga njësia apo numri i produkteve ose të ngjashme që njësia pret të përfitojë nga përdorimi i këtyre lloj aktiveve.

- Amortizimi në sektorin publik ka veçori, sepse nuk ka ndikim në shpenzime, por në fondet bazë të njësisë së qeverisjes së përgjithshme.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga MEI, Sektori i financës të merren masat për përlllogaritjen e amortizimit të aktiveve afat gjata materiale dhe jo materiale si konstatim kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezulton nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të pakthyeshme (përfundimtare) për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: *“Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët”* (Klasa 4) Formati nr. 1, llog. 4342 *“Të tjera operacione me shtetin (debitor)”* zënë shumën **796,929** mijë (*Inventari i llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” dt. 31.12.2017*) e cila pasqyrohet në bilanc në pasiv, Formati nr. 2 në analizë dhe përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2018 si; *“Klientë (kreditorë), parapagesë pjesore”* (llog. 419) për 1,406 mijë lekë, *“Furnitorë e llogari të lidhura me to”* (llog. 401-408) për 673,211 mijë lekë, *“personeli e llogari të lidhura me to”* (llog. 421-423) për 17,920 mijë lekë, *“Të drejta dhe taksa për tu derdhur në shtet”* (llog. 431) për 2,584 mijë lekë, për *“sigurime shoqërore”* (llog. 435) në vleftën 6,003 mijë, *“sigurime shëndetësore”* (llog. 436) në vleftën 760 mijë, *“Kreditorë të ndryshëm”* (llog. 467) në vlerën 345,638 mijë lekë.

Pra si shikohet dhe nga pasqyra e aktivitet dhe pasivitet rezulton se shumat e detyrimeve afat shkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2018 nuk rezulton e barabartë me vlerën e “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” për 250,592,934 lekë. Kjo shumë në pasqyrën e aktivitet është pasqyruar në llog. e tjera aktive 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Në sektorin publik dallohen rastet e përdorimit të disa llogarive specifike të lidhur me të drejtat e detyrimet që evidentojnë institucionet për marrëdhëniet me shtetin (4342 e 4341), si të drejta dhe si detyrime.

-Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (debitor) (të drejta)”

-Llogaria 4341, “Operacione me shtetin (kreditor) (detyrime)”.

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Në zbatim të nenit 61 të ligjit të buxhetit, lidhur më njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet, në fund të periudhës raportuese duhet të paraqiten në kontabilitet, si më poshtë:

-Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse të cilat evidentojnë të drejta të njërive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”).

-Nga MEI, Sektori i financës të merren masat rregulluese, që në pasqyrat financiare vjetore, në rubrikën e të drejtave, të paraqiten detyrimet që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, nga grantet korrente apo kapitale që merren nga buxheti i shtetit si dhe rastet specifike, pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore, detyrime për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por që paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

-Detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare, duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare. Në këtë rast, duhet të mbahet nën kontroll evidentimi joreal i detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”).

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) në vlerën 673,211 mijë lekë ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre:

Në analizë kjo llogari rezulton:

-Llogaria 401, “Furnitorë” në vlerën 6,714 mijë lekë (Na analizë përbëhet nga 8 furnitorë të vitit në vazhdim për fatura të muajit dhjetor 2017);

-Llogaria 404, “Furnitorë për aktive të qëndrueshme” në vlerën 267,277 mijë lekë të vitit në vazhdim. (Në analizë përbëhet nga 26 Urdhër shpenzimesh të muajit dhjetor 2017, të cilat nuk janë ndarë mbi bazën e furnitorëve);

-Llogaria 405, “Efekte për tu paguar për aktivet e qëndrueshme” në vlerën 399,220 mijë lekë (Në analizë përbëhet nga 11 vlera pa u ndarë sipas furnitorëve dhe se sa i takon “Efekte për tu paguar për aktive të qëndrueshme të vitit të mëparshëm” dhe sa për vitin në vazhdim.

Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër

Për sa më sipër rikërkojmë:

Drejtuesit MIE, në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të rishikojnë nëse janë marrë masat e nevojshme për njohjen dhe ndarjen reale të detyrimeve sipas standardeve të kontabilitet, për raste kur subjekti detyrohet që të transferojë përfitime ekonomike si

rrjedhoje e transaksioneve ose ngjarjeve nga e kaluara. Me qëllim të shmangies së gabimeve, duhet të bëhet harmonizimi i llogarisë së kontabilitet me furnitorët duke trajtuar saktësinë dhe plotësinë e këtyre llogarive.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në llogaritë e tjera janë pasqyruar “Kreditorë për mjete në ruajtje” (llog. 466) në vlerën 1,089,319,696 lekë (*Në analizë përbëhet nga vlerat kreditore për 43,361,726 lekë, të cilat janë garanci bankare pa u ndarë mbi bazën e kreditorëve dhe pa u saktësuar nëse janë garanci bankare të vitit në vazhdim, të vitit të mëparshëm apo të viteve të mëparshme*). Në këtë llogari gjithashtu janë evidentuar tepricat e të ardhurave të trashëgueshme në vlerën 1,045,957,970 lekë të vërtetuara me aktet e rakordimit me thesarin.

-Në aktrakordim, tepricat nuk janë paraqitur të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (*të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet*). Në kredi “Kreditorë për mjete në ruajtje” (llog. 466) përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve.

-Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (*të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466*), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

-Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (*të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet*).

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Nga MIE të merren masat që periodikisht kur trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, të pasqyrohen në llogarinë disponibiliteteve në thesar, kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu, llogaria 520 do pasqyrojë edhe gjendjen e mjeteve në ruajtje (*të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466*), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

-Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (*të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet*).

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në llogaritë e klasës 4 “Detyrime afat shkurtra” janë paraqitur në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 345,638 mijë lekë si detyrime afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2018.

Në analizë kjo llogari përbëhet nga detyrimet sipas urdhër shpenzimeve të muajit dhjetor 2017 në vlerën 42,320,858 lekë dhe detyrime të pa likuiduara deri në vitin 2016 në vlerën 52,724,381 lekë. Gjithashtu janë përfshirë dhe detyrimet e prapambetura në vlerën 250,592,934 lekë të cilat janë pasqyruar në aktiv në llogarinë (llog. 486) “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Nga pasqyra analitike e urdhër shpenzimeve për llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” rezulton se detyrimet e pa likuiduara deri në vitin 2016 në vlerën 52,724,381 lekë nuk janë përfshirë në detyrimet e prapambetura. Në rast se do pasqyrohen ndryshimet rezulton se detyrimet e prapambetura janë në vlerën **300,131,698** lekë (250,592,239 - 3,185,617 + 52,724,381 = 300,131,698 lekë), në kundërshtim me UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014”: “Detyrime të prapambetura për punë të kryera, për efekt të këtij udhëzimi konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të pa paguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës”.

Nr.	Fatura të pa likuiduara nga MEI nga vitet e kaluara + 2016	Lekë
1	A.	249,900
2	Blerje Bileta	188,305
3	Vendime gjyqësore	51,993,719
4	Publikime në Shtyp	172,000
5	Shpenzime të tjera	120,457
	TOTALI	52,724,381

Për sa më sipër rikërkojmë:

- Të merren masat nga MIE, sektori i financës të saktësojnë dhe evidentojnë në pasqyrat financiare vjetore detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për punë të kryera, të përcaktuara nga një kontratë, marrëveshje, vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të pa paguara për shkak të mungesës së fondeve 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës.
- Të përcaktojnë rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigoroze mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në llogaritë e tjera aktive janë pasqyruar “Shpenzime të periudhave të ardhshme” (llog. 486) në vlerën 250,592,934 lekë e cila në analizë përbëhet nga detyrime të faturuara në fund të vitit 2017 në vlerën 6,149,601 lekë dhe detyrime për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë dhe që i përkasin kryesisht vitit 2016 dhe 2017 të cilat janë detyrime të prapambetura sipas akteve ligjore në fuqi, dhe nuk janë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm.

Vlerat e mësipërme nuk janë llogaritur dhe nuk janë regjistruar në llogarinë 4342 “Marrëdhënie me shtetin debitor” si detyrimet buxhetore, të lindura por të pa likuiduara dhe që parashikohen të likuidohen me fondet buxhetore të vitit të ardhshëm duke denaturuar llogarinë (llog. 486) “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Në këtë llogari janë evidentuar veçmas detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, Llogaria 486, “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh., qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë dhe të tjera. Me UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014”: “Detyrime të prapambetura për punë të kryera, për efekt të këtij udhëzimi konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të pa paguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës”. UMF nr. 14 date 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit

vendor dhe njësisive që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”; Rakordohet llogaria 4342 “Marrëdhënie me shtetin debitor” për pagesat e bëra për detyrimet e një viti më parë. Krahas pagesës që është bërë (debi klasa 4 për detyrimet në kredi 520 “Disponibilitete në thesar” e bërë gjatë vitit) të verifikohet dhe në rast se nuk është kryer të bëhet veprimi (që është paralel) debi llogaria 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur” në kredi të 4342 “marrëdhënie me shtetin debitor”. Rakordohen, llogariten dhe regjistrohen në llogarinë 4342 “Marrëdhënie me shtetin debitor” detyrimet buxhetore, të lindura por të pa likuiduara dhe që parashikohen të likuidohen me fondet buxhetore të vitit të ardhshëm, me veprimin kontabël debi llogaria e mësipërme 4342 në kredi të llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Për sa më sipër rikërkojmë:

- Nga MIE, Sektori i Financës të merren masat për saktësimin, rregullimin dhe evidentimin kontabël, në llogaritë rregulluese të pasqyrave financiare, të shpenzimeve të periudhave të ardhshme që përfaqësojnë blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh., qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara në avancë dhe të tjera.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura gjendje në datën 31.12.2017 rezulton se:

-Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6937, dt. 02.05.2018 “Dërgohet raportimi periodik për detyrimet e prapambetura dhe të krijuar rishtazi” i janë dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportimi i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2017 dhe të detyrimeve të krijuar rishtazi..... ku simbas pasqyrës bashkëngjitur shkresës rezulton se vlera e këtyre detyrimeve të konsoliduara për vitin 2017 rezulton në **151,082,956** lekë e përbërë nga studime e projekte dhe vendime gjyqësore.

-Referuar raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detyrimet e prapambetura deri 31.12.2017 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë rezultojnë **3,254,800,000** lekë (*Publikuar në web-in e MFE*).

-Referuar pasqyrave financiare të konsoliduar vlera e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2017 është **985,860,739** lekë të paraqitura në llogarinë llog. 486; “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në analizë si mbas subjekteve:

Nr	Shkresa			llog. 486
	nr.	dt.		
1	21	08.03.2018	Agjencia kombëtare bërthamore	0
2	396	13.04.2018	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të territorit	0
3	240	27.02.2018	Autoriteti kombëtar për sigurinë dhe emergjencat	0
5	1604/1	07.03.2018	Inspektorati shtetëror teknik dhe industrial	0
6	341	27.02.2018	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	0
7	1-Dec	05.03.2018	Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve	0
8	34	30.01.2018	Drejtoria e Inspektimit hekurudhor	0
9	27/1	28.02.2018	Instituti I Transportit	0
10	111	27.02.2018	Drejtoria e Përgjithshme Detare	0
11	2354	26.03.2018	Autoriteti rrugor Shqiptar	577,094,220
12	375	26.02.2018	Agjencia Kombëtare e ujësjellës kanalizime	158,173,585
13	251/1	23.02.2018	Arkivi Qendror Teknik I Ndërtimit	0
14	6275/1	20.04.2018	MIE	250,592,934
			Shuma	985,860,739

Nga sa konstatohet më sipër rezulton se vlerat e raportuara për datën 31.12.2017 nga MIE sipas raportimit të datës 02.05.2018 (151,082,956 lekë), vlerat e raportuara në pasqyrat financiare të konsoliduara (985,860,739 lekë) dhe vlerave të raportuara në buletin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (3,254,800,000 lekë) nuk janë të njëjta.

Me UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014”: pika 30; “Detyrime të prapambetura për punë të kryera, për

efekt të këtij udhëzimi konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të pa paguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës”.

Pika 32; “Shuma e detyrimeve dhe të drejtave të konstatuara e paraqitur në bilancin e njësisë dhe e raportuar në Ministrinë e Financave, duhet të jetë objekt verifikimi nga ana e institucioneve të zbatimit nga ana e nëpunësve zbatues të parimeve të raportimit financiar mbi plotësinë, transparencën dhe vërtetësinë e informacionit financiar”.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga MIE, të merren masat për rakordimin përfundimtar të llogarive të kreditorëve, debitorëve, saktësimi dhe evidentimi i detyrimeve të prapambetura për punë të kryera, ë përcaktuara nga një kontratë, marrëveshje, vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të pa paguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës.

Të saktësohen shumat e detyrimeve, të drejtave të konstatuara (detyrimet e prapambetura) të paraqitura në pasqyrat financiare të njësisë dhe ato të konsoliduara, mbi bazën e parimeve të raportimit financiar mbi plotësinë, transparencën dhe vërtetësinë e informacionit financiar dhe të raportohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

a. Në aktiv formatin nr.1, në llogaritë e kërkesave arkëtimi mbi debitorët janë pasqyruar “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba” (llog. 423, 429) në vlerën 403,637 lekë e cila në analizë përbëhet kryesisht nga 10 debitorë të viteve të kaluar (2015-2016) të ish MEI dhe ish MTI për paradhënie të pa mbyllura, për të cilët nuk ka praktikë njoftimi, kërkesë arkëtimi ose procese gjyqësore për personat debitorë për paradhënie të pa kthyer.

b. Në llogaritë e kërkesave arkëtimi mbi debitorët janë pasqyruar “Debitorë të ndryshëm” (llog. 468) në vlerën 486,872,416 lekë e cila në analizë përbëhet kryesisht nga 9 debitorë të viteve të kaluar (2015-2016) të MEI, për të cilët nuk ka praktikë njoftimi ose procedura ligjore juridike për të arkëtuar vlerën nga subjektet debitorë. Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Për sa më sipër rikërkojmë:

a. Drejtuesit e MIE duhet të sigurojë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

b. Nga organet Drejtuese të MIE të rivlerësohen llogaritë e njësisë ekonomike për shumave pa shpresë arkëtimi të klientëve dhe debitorëve të ndryshëm pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 1,168,490,946 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur nga shuma e garancive (garanci kontrate dhe garanci 5%) në vlerën 1,089,319,696 lekë në pasivin e bilancit është paraqitur në llogaritë; 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” dhe diferenca të ardhura nga taksa e infrastrukturës në vlerën 79,171,250 lekë (Aktrakordimet me thesarin) e cila është pasqyruar në llogarinë 85 “Rezultati i ushtrimit” për vlerën 7,954,901 lekë kurse diferenca prej 71,216,349 lekë si rezultat i ushtrimit të mëparshëm duhej të pasqyrohej në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”.

-Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të

evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 1,089,319,696 lekë), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

-Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

-Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vehte dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si teprice kreditore e kësaj llogarie në vlerën 7,954,901 lekë (Të ardhurat 2,972,002,043 – shpenzimet 2,964,047,142 = 7,954,901 lekë). (Akti i rakordimit me thesarin si të ardhura nga taksa vendore e infrastrukturës për vlerën 7,954,901 lekë).

-Në pasivin e bilancit, formati nr. 2, Llog. Nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 0 lekë kur në fakt duhej të paraqitej për vlerën 79,643,724 lekë.

Në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësohej pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm (2016) dhe të realizohej transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” për vlerën 79,643,724 lekë në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur” në vlerën 79,643,724 lekë.

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Nga MIE, sektori i financës të merren masat që periodikisht tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordimet me degën e thesarit, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

-Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” duhet të përfaqësojë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës dhe si tepricë debitore, kjo llogari duhet të përfaqësojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

-Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Pasqyra e bilancit “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investime” zëri “Shpenzime për rritjen e AQ” formati 4/e e plotësuar për shumën 1,890,803.209 lekë, duhet të jetë në vlerën **2,078,912,186** lekë shumë e cila rezulton nga shumat e “shpenzimeve për rritjen e AQ të trupëzuara” që janë në vlerën 196,955,649 lekë dhe “shpenzimeve për rritjen e AQ të trupëzuara” në vlerën 1,881,956,537 lekë.

Vlera e shpenzimeve për investime formati 4/e në vlerën 2,078,912,186 lekë gjithashtu nuk rakordon me vlerën prej 2,010,619,085 lekë e paraqitur në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 6. me një diferencë prej 68,293,101 lekë.

Në pasqyrën e mësipërme formati 4/e gjithashtu janë pasqyruar edhe shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara në vlerën 196,955,649 lekë kur në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” në formatin 6, kolona e dytë shuma për aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara janë e ndarë sipas zërave të

investimeve “*Studime e kërkime*” në vlerën 25,072,000 lekë, “*shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuar*” në vlerën 103,590,548 lekë gjithsej 128,662,548 lekë me një diferencë prej 68,293,101 lekë janë paraqitur shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzua në formatin 6, kolona e dytë.

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke saktësuar shumat e evidentuara në llogaritë e shpenzimeve për rritjen e aktiveve materiale e jo materiale, për një pasqyrim më të drejtë të burimeve dhe shpenzimeve lidhur me investimet, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

-Pasqyrat financiare vjetore, të përmbajnë një informacion më të plotë shpjegues, lidhur me pasqyrimin e fondeve, pasi konstatohet mungesa e informacionit mbi shpjegimet e nevojshme për mospërputhjet e vlerave në disa llogari të bilancit kontabël.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, nga subjekti për vlerën e klientëve dhe furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mosrakordimi me klientët dhe furnitorët mundëson edhe riskun e pagesave të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë e të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare.

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Drejtuesit e MIE, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të konfirmojnë (Rakordojnë) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

-Të përcaktojnë rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigorozë mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se Formatu 12 “*Pyetësor dhe shënime shpjeguese*” është plotësuar, relacioni shpjegues për pasqyrat financiare, por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me shënime shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënime të japin përshkrime me fjalë apo zberthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 405, dt. 29.12.2017 “*Ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim..... dhe ambientet e MIE*” nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me

gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime te mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve.

-Procesi i inventarizimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, siç përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr. 30, që përcakton se “*ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfundim bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale*”, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast. Komisioni nuk ka pasqyruar vitin e blerjes apo të bërjes hyrje të aktiveve dhe nuk ka një analizë për destinacionin përfundimtar, mundësinë e riparimit të pajisjeve, etj, sipas përcaktimeve të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, vlerësimi i Aktiveve.

-Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit sipas tre procesverbaleve të hartuar në vlerën **24,191,155** lekë, por nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit dhe të vepronin konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011, si për: *procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; procesin verbal të vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme*, duke marrë si reference paragrafin 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrit të Financave.

-Nga MIE për vitin 2017 nuk janë inventarizuar e kontrolluar për ekzistencën dhe vlerësimin të gjitha aktivitet afatgjata materiale dhe jo materiale, aktivitet afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës (*ish MEI dhe ish MTI*) për vlerën 645,212,161 lekë.

Llog.	Emërtimi	Ish MZHU	Ish MEI	Ish MTI	Dhjetori
1	2	3	4	5	6
202	Studime e kërkime				
230	Shp.. Për. Rr.Akt. të paqënd.		3,687,060	33,337,685	25,072,000
210	Toka, troje, terrene		0	3,389,440	0
212	Ndërtime e konstruksione		237,121,668	127,124,448	161,233,878
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore		1,232,140	0	0
214	Ins. Teknike makineri pajisje		39,813,842	0	0
215	Mjete transporti		0	0	0
218	Inventar ekonomik		0	0	13,200,000
312	Materiale		0	0	0
327	Objekte inventari		0	0	0
	TOTALI		281,854,710	163,851,573	199,505,878

Për aktivitet e mësipërme nuk është kryer inventarizimi i plotë bazuar në Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 405, dt. 29.12.2017 “*Ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim. dhe ambientet e MIE*” dhe në kundërshtim me nenin 7, “*Inventari i aktiveve dhe detyrimeve*”, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Inventarizimi i aktiveve.

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Nga MIE, të merren masat që inventarizimi i aktiveve të bëhet për vitin e plotë ushtrimor, me qëllim pasqyrimin e saktë dhe real të vlerës së inventarit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të subjektit, në përputhje me të Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

-Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Nga strukturat e menaxhimit të MIE të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, ... duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

-Në rast miratimi, nga sektori i financës, të bëhet reflektimi, në pasqyrat financiare të periudhës raportuese të vlerës së aktiveve afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit dhe/ose asgjësimin e tyre nga komisionet përkatëse si ngjarje të ndodhura në periudhën e raportimit financiar si një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese.

- Drejtuesit e MIE duhet të forcojnë kontrollin në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për vlerësim të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Nëpunësi Zbatues detyrimisht para se të kryhet inventarizimi fizik i aktiveve nga komisionet përkatëse, është i detyruar që tu vejë në dispozicion regjistrat e aktiveve sipas gjendjeve kontabël, ku komisionet kanë për detyrë për të evidentuar sasitë fizike.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi:

Gjatë auditimit të transaksioneve me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë nëpërmjet teknikave të auditimit si: *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, rezultoi se:*

-Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, nuk pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

-Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit nuk është bazuar gjithmonë në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim; dokumentet autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj. Sa konstatuar gjetjet më poshtë:

Për kontratën me nr. 5663/7, dt. 18.12.2017 lidhur midis MIE dhe B “A...” shpk dhe “K...” shpk për “**Software** për certifikimin energjetik të ndërtesave, regjistrimin dhe certifikatës PEN”, me vlerën 17,000,000 lekë pa tvsh si ofertë fituese, është likuiduar Urdhër shpenzimi nr. 181, dt. 29.12.2017 për vlerën 12,540,000 lekë.

a. Komisioni për marrjen në dorëzim të “**Software** për certifikimin e energjetik të ndërtesave, regjistrimin dhe certifikatës së PEN” nuk është shprehur për rezultatet që duhet të arrihen nga ky “software” të kërkuara në termat e referencës si: *Ndërtim, Instalim, setup, konfigurim, testim dhe vënie në punë të softëare për aplikimet online për certifikimin energjetik të ndërtesave dhe regjistrimin e certifikatës së PEN në infrastrukturën ekzistuese në Datacenter-in e AKSHI-it; Krijimi dhe publikimi i formularit për aplikimin e subjekte për marrjen e certifikatës së PEN. Implementim në DIS ekzistues i librarisë së ndërveprimit të MEI, të implementojë proceset për*

menaxhimin sipas tipologjive të çështjeve, Krijimi dhe konfigurimi i procedurave të arshivimit të informacionit sipas frekuencave të dakordsuara me Agjencinë e Efiçencës së Energjisë për regjistrimin e certifikatave, Kontraktori duhet të sigurojë manual në gjuhën shqipe të përditësuar sipas implementimit që do të bëhet në projektin konkret, Kontraktori duhet të bëjë trajnimet për të gjithë stafin që do të përdorë këtë sistem.

b. Nga autoriteti kontraktor nuk ka një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 4. “Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.”

c. Operatori B “A...” sh.p.k & “K...” shpk në formularin e ofertës në formatin elektronik dhe në dosjen e operatorit me shkrim ka deklaruar vlerën 17,480,000 lekë pa tvsh, dhe 20,976,000 lekë me tvsh kurse në analizë referuar zërave të preventivit ka paraqitur vlerën 17,000,000 lekë pa tvsh dhe 20,400,000 lekë me tvsh, me një diferencë prej **480,000** lekë pa tvsh 2.8% e ofertës ose 576,000 lekë me tvsh. KVO ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4.

Midis operatorit “S..A...” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 4004/6, datë 11.10.2017 për kryerjen e shërbimit dhe riparimit të automjeteve të MEI për vitin 2017” në vlerën 1,331,800 lekë pa t.v.sh. ose 1,598,160 lekë me tvsh me afat kontrate deri 31.12.2017. Nga auditimi rezulton se nga **MIE janë likuiduar katër urdhër shpenzim të cilat kanë bashkëngjitur fatura tatimore të lëshuar për një periudhë më të madhe se një muajore.** Kjo në kundërshtim me VKM nr. 50, 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” “..... detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor (kontratat e financuara nga qeveria qendrore) dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore e shëndetësore”.

Nga auditimi i likuidimeve të vlerave të kontratës me objekt “Ndërtimin dhe administrimin e Impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë”, sipas VKM nr. 907, dt. 17.12.2014 “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë” rezultoi se:

-Me urdhrin e shpenzimit nr. 27, dt. 04.12.2017 nga MIE janë likuiduar vlera prej 87,714,642 lekë (kësti 34, dt. 31.10.2017 dhe kësti 35, dt. 31.11.2017 gjithsej 656,252 Euro) në favor të “A...” shpk.

-Me urdhrin e shpenzimit nr. 109, dt. 26.12.2017 nga MIE janë likuiduar vlera prej 43,594,820 lekë (kësti 36 dt. 31.12.2017 për 328.126 Euro) në favor të “A...” shpk. Bashkëngjitur Urdhrave të shpenzimit janë Urdhrat e pagesës nga Ministri për kryerjen e pagesave për këstet mujore në zbatim të kontratës shoqëruar me shkresat përcjellëse që shoqërojnë situacionet përkatës.

Vlerat e punimeve të kryera sipas situacioneve përkatëse nuk janë shoqëruar me fatura tatimore përkatëse nga operatori. Gjithashtu nuk ka një raport përmbledhës mbi punimet e kryera deri në periudhën raportuese nga mbikëqyrësit në rastin konkret nga Njësia e Zbatimit të Projektit. Dokumentet shoqëruese një pjesë e tyre janë fotokopje.

Me urdhrin e shpenzimit nr. 90, dt. 19.12.2017 nga MIE janë likuiduar vlera prej 40,140,350 lekë (340,000 Euro) në favor të “G.Ë.” (UK) LL.P si pagesë e tarifës së avokatëve dhe ekspertëve për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICSID CASE nr. ARB/15/28, “H. s.r.l. & O.” kundër Republikës së Shqipërisë.

Bashkëngjitur urdhër shpenzimit një pjesë e dokumenteve janë fotokopje. Gjithashtu mungon shtesa e kontratës për ofrimin e shërbimeve juridike e lidhur me “G.Ë.” (UK) LL.P.

Me urdhrin e shpenzimit nr. 178, dt. 99.12.2017 nga MIE janë likuiduar vlera prej 13,398,350 lekë (100,000 Euro) në favor të “B...” (UK) LL.P si pagesë e tarifës së ekspertit të angazhuar për vlerësimin e dëmeve për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICSID CASE nr. ARB/15/28, ”H. s.r.l & O.” kundër Republikës së Shqipërisë.

Bashkëngjitur urdhër shpenzimit janë shkresa e avokaturës së shtetit nr. 493/60, dt. 03.10.2017 që shoqërojnë faturën (invoice) nr. 1651242 për vlerën 100,000 Euro dhe Kontrata me BDO dt 15.04.2016. Shkresa e Avokaturës së Shtetit dhe kontrata me “B” nuk janë origjinale (fotokopje).

Me urdhrin e shpenzimit nr. 165, dt. 29.12.2017 nga MIE janë likuiduar vlera prej 10,000,000 lekë në favor të përmbaruesit privat Besart Shehu sipas vendimit gjyqësor nr. 1354, dt. 07.06.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për çështjen gjyqësore me palë paditëse “Z...GRUP..” sha ku në vlerën e mësipërme përfshihet edhe tarifa e shërbimit përmbarimor në vlerën 1,894,165 lekë.

Mungon bashkëngjitur urdhër shpenzimit fatura tatimore e lëshuar nga përmbaruesi për vlerën e shërbimit përmbarimor.

Sa konstatuar më lart është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj dhe pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës ”,*

Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” kreu VIII, pika 2/b, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 3, “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë ”.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga MEI, Sektori i Financës të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare:

-Sektori i Financës në mbajtjen e kontabiliteti duhet të mbështet në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues si: Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje, mandatarkëtim/pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit; Urdhër shpenzimi që përdoret në marrëdhëniet e subjektit me degën përkatëse të thesarit; libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet;

-Sektori i Financës për transaksionet që bëhen me fondet buxhetore, duhet të kontrollojnë në se urdhri i shpenzimit ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton shërbimin, marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i transaksioneve dhe dosjeve të procedurave të prokurimeve u konstatua:

Për të gjithë tenderat e audituar, NJP-të nuk kanë evidentuar marrjet në dorëzim të paketave të dokumenteve të fitueseve të tenderave, para se të lidhen kontratat përkatëse.

Mos kryerja e këtij është në kundërshtim me LPP, Kreu II, neni 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 3, si dhe VKM nr. 914, datë 29/12/2014, i ndryshuar, neni 64. Dosjet e procedurave të prokurimeve nuk janë të inventarizuara në mënyrë të rregullt si dhe nuk janë arkivuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, mangësi e cila vështirëson dhe nuk bën të mundur auditimin e dokumentacionit sipas radhës kronologjike kohore të kryerjes së tyre.

Për sa më sipër rikërkojmë:

-Titullari i AK, të marri të gjitha masat për të ardhmen, që para se të lidhen kontratat me fituesit e tenderave, të nxjerrë urdhrin për NJP për ti kontrolluar të gjitha praktikatat dokumentare të paraqitur fizikisht me ato të raportuara në platformën elektronike të faqes së APP-së dhe të dokumentojnë marrjen e tyre në dorëzim nga OE fitues i tenderit, konform legjisllacionit të prokurimeve.

-Të merren masat nga MIE për inventarizimin në mënyrë të rregullt dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimeve në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Në MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Njësia e Prokurimit (NJP) nuk ka funksionuar më vete në përbërje të strukturës organike, por gjatë vitit, si anëtar të NJP-ve, caktohen punonjës të ndryshëm. Në këtë AK, ka zhvillime tenderash në një numër të konsiderueshëm dhe me procedura të ndryshme. NJP-ja ka shumë përgjegjësi sipas legjisllacionit të prokurimit publik në fuqi. Nga NJP-të këto detyra nuk janë realizuar të gjitha dhe mangësitë e shkeljet e konstatuara, mund të ishin shmangur, shumica prej tyre, nëse NJP-ja do të funksiononte si strukturë më vete, si dhe po të ishin kryer edhe trajnimet e nevojshme pranë APP-së.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MIE, në varësi të burimeve njerëzore, që ka në dispozicion të shikojë mundësinë, për të ngritur funksionimin e strukturës së posaçme të prokurimit publik, e kjo në zbatim të nenit 57 “Njësia e Prokurimit” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim edhe të sigurimit të mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale duke rritur eficientësinë, ekonomicitetin dhe efektivitetin në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës sipas deklaratës doganore SAD ose datës sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si “taksa e markimit”. Konstatohet se për zbatimin e kontratës me subjektin komisioni për marrjen në dorëzim nuk shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara të shoqëruara me raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe deklaratën doganore SAD. në kundërshtime Urdhrin nr. 387, dt. 23.12.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 3, “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë / pika 5 dhe 6, “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF- Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga MIE në zbatimin e kontratave dhe likuidimin e vlerës së mallrave të furnizuara të merren masat si vijon:

-Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës dhe me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës.

-Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas deklaratës doganore SAD, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i funksionimit të sistemit të Menaxhimit financiar dhe Kontrollit rezultoi se:

-MIE bazuar në VKM nr. 504, datë 13.9.2017 *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”* është krijuar si strukturë e re organizimi, subjekt relativisht i ri, i cili harton dhe zbaton e politikat e përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë sektorë të cilët më parë vareshin nga struktura të veçanta organizative.

Struktura organizative nuk është e argumentuar nëse është në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e njësisë dhe nëse strukturat përgjithësisht janë të përshtatshme për të arritur objektivat e institucionit. Fondet buxhetore (**47,852,630** mijë lekë) që menaxhon MIE si çelje nga buxheti i vitit 2018 sipas 11 programeve, pa fondet me financimet e huaja:

Programi *“Planifikim menaxhim administrim”* për 691,987 mijë lekë.

Programi *“Transporti rrugor”* për 14,180,301 mijë lekë.

Programi *“Transporti Detar”* për 150,260 mijë lekë.

Programi *“Transporti Hekurudhor”* për 437,680 mijë lekë.

Programi *“Transporti Ajror”* për 25,110 mijë lekë.

Programi *“Furnizimi me Ujë dhe kanalizime”* për 3,532,992 mijë lekë.

Programi *“Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”* për 2,064,272 mijë lekë.

Programi *“Mbështetje për Energjinë”* për 1,623,900 mijë lekë.

Programi *“Mbështetje për Burimet Natyrore”* për 551,200 mijë lekë.

Programi *“Mbështetje për Industrinë”* për 406,740 mijë lekë.

Programi *“Planifikimi Urban”* për 292,700 mijë lekë.

Totali = **47,852,630** mijë lekë.

-Nga auditimi mbi menaxhimin financiar në MIE rezulton se aktualisht nuk ka një rregullore të miratuar, por vazhdojnë të zbatohen rregulloret e ish ministrive, ish MZHU, ish MTI dhe ish MEI. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, ku shprehet se: *“Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij”*.

-Nga auditimi u konstatua se referuar strukturës organike dhe organigramës, në përcaktimin e nëpunësit zbatues nuk ka gjetur zbatim neni 12 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar *“Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”*, ku cilësohet se, *“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë”*. Nga auditimi konstatohet se, nëpunësi zbatues nuk është në varësi direkte nga nëpunësi autorizues pasi në strukturën e miratuar Drejtori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar përgjigjet edhe përpara Drejtorit të Përgjithshëm Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse, i cili nga ana e tij përgjigjet dhe raporton përpara Sekretarit të Përgjithshëm.

-Kontrolli i brendshëm nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin tërë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për të siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

Nuk ka një sistem informatik informacioni, monitorimi që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë. Aktualisht kryhet me një kordinator i cili mbledh dhe raporton tek drejtuesit dhe në Kryeministri, për nivelin e realizimit të objektivave të materializuara në produkte.

-Nuk ka një procedurë të veçantë të shkruar nga menaxhuesit, përtej legjislacionit në fuqi për ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar për aktivet e rëndësishme (me vlerë) dhe aktivet afatgjata (përfshirë të dhënat personale). Gjithashtu nuk ka manual procesesh ose rregullore për proceset kryesore operationale dhe financiare i cili të specifikojë qarkullimin e dokumentacionit.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MIE, strukturat menaxhuese të marrin masat të rishikojnë strukturën e institucionit si dhe të hartojnë rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, në përshtatje me strukturën e re dhe objektivat e institucionit përcaktuar nga VKM nr. 504, datë 13.9.2017 “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*” duke e plotësuar dhe harmonizuar me kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe miratuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se raportet e monitorimit nuk publikohen në **web-in** e MIE dhe as në **web-in** e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, gjithashtu raportet e monitorimit nuk kanë informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungon një analizë me argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.

Nuk është e paraqitur Performanca e produkteve e lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva në kundërshtim

Gjithashtu të dhënat e raportuara në raportet e monitorimit nuk rakordojnë me pasqyrat financiare dhe aktet e rakordimit me degën e thesarit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 19.01.2018, Kreu V, pika 101, ku citohet: “*Raporti i monitorimit për vitin 2017, si dhe raportet periodike për vitin 2018, që ministritë dhe institucionet do të paraqesin në Ministrinë e Financave, duhet të plotësohen në përputhje me UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësinë e Qeverisjes Qendrore”, paragrafi 49.*

Për sa më sipër rikërkojmë:

Nga MIE të hartohen Raportet e Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të cilat duhet të përmbajnë një informacionin të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, raportimin lidhur me ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave të politikës që trajtojnë nëpërmjet treguesve të performancës përkatëse në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm si dhe çdo problematikë të rezultuar, duke specifikuar dhe masat e nevojshme për adresimin e tyre në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë, të vitit 2019.

20. MINISTRIA E MBROJTJES

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes ,për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 243, datë 21.12.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 201/21, datë 22.12.2018, konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti **ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve** nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.

-Nga ana e subjektit **nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 muor**, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **69** rekomandime gjithsej, nga këto, 1 propozim për përmirësim ligjor, 39 masa organizative, 21 masa zhdëmtimi, 3 masa disiplinore, dhe 5 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore është lënë **1** dhe është në proces zbatimi.
- b. Masa organizative janë lënë **39** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 39, janë zbatuar 22, në proces 12 dhe janë pa zbatuar 5.
- c. Masa për shpërblim dëmi janë lënë **21** rekomandime për shumën 66,414 mijë lekë nga të cilat, janë pranuar 12 rekomandime në vlerën 7,038 mijë lekë, janë në proces zbatimi 12 masa në vlerën 7,038 mijë lekë dhe nuk janë pranuar 9 rekomandime në shumën 59,376 mijë lekë.
- d. Masa për eliminimin e efekteve negative janë lënë **5** rekomandime për shumën 1,162,469 mijë lekë nga të cilat, janë pranuar 3 rekomandime në vlerën 1,081,548 mijë lekë, janë në proces zbatimi 2 masa në vlerën 1,013,651 mijë lekë dhe pa pranuar 80,920 mijë lekë.
- e. Mbështetur në nenin 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i është rekomanduar titullarit të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkoj fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore e administrative.

I. Në përfundim **rikërkojmë** nga *Ministria e Mbrojtjes*, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. **nr. 201/15, datë 10.10.2018**, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e përputhshmërisë”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi ose të papranuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

3. Gjetje: Aktualisht, numri i helikopterëve që ka në TOP Forca Ajrore (FAJ) është 25 (TOP është tabelë që tregon mjetet e deklaruara që janë përfshirë në regjistrin ligjor për shfrytëzim/përdorim nga FAJ. Për mjetet jashtë TOP, ligjërisht, nuk lejohet të vihen në përdorim dhe nuk mund të kryesh shpenzime për to). Nga të dhënat (e mirëmbajtjes të helikopterëve, për vitet 2014 – 2017) rezulton se numri maksimal i helikopterëve në gatishmëri operacionale ka arritur në 8 helikopter . Gatishmëria kaq e ulët, është e lidhur kryesisht:

Me numrin e lartë të tipeve të helikopterëve (janë *tre linja/ teknologji prodhimi* dhe dhjetë tipe të ndryshëm), vjetërsinë (moshën) e tyre, e cila shoqërohet me shpenzime të mëdha financiare për mirëmbajtjen (në vitin 2017 për mirëmbajtjen rutinë, niveli më i ulët, janë shpenzuar rreth 139,000 mijë lekë).

Shpenzimet për këto mjete bëhen më pak efektive duke pasur në konsideratë se krahas shpenzimeve direkt për blerjen, janë shpenzuar fonde të konsiderueshme për kualifikimin e personelit dhe reduktimi i tipit të mjeteve, ka bërë që efektiviteti i shpenzimeve të jetë edhe më i ulët. Për çdo tip helikopteri, kërkohet kualifikim dhe pajisje/vegla pune të kushtueshme të veçanta për personelin.

Kjo shumëllojshmëri, rrit më tej kostot pasi për tipet e vjetër pjesët e këmbimit nuk gjenden, kanë çmime të larta etj, por njëkohësisht nuk lejon/krijon mundësinë që pjesët e këmbimit të rregullta të një mjeti të reduktuar, ose jo në gatishmëri, të përdoren nga një mjet tjetër, me pasojë rritjen e numrit të mjeteve që nuk janë në punë

Për sa më sipër rikërkojmë:

Blerja e mjeteve ajrore të mbështetet në nevojat që ka vendi, në përmbushje edhe të detyrimeve ndaj objektivave dhe standardeve të NATO, por mbi të gjitha, në mundësitë financiare për mirëmbajtjen periodike deri në një periudhë kohore të pranuar teknikisht për këto mjete. Nën këtë arsyetim, për të rritur efektivitetin e shpenzimeve, është e nevojshme që Institucioni, të blejë aq mjete sa ka mundësi t'i mirëmbajë. Blerja e mjeteve të orientohet në kufizimin e mundshëm të linjave të prodhimit deri në dy dhe tipologjisë së mjeteve deri në katër tipe, çka që do të thotë një reduktim të tipeve në masën rreth 58 për qind kundrejt numrit aktual të mjeteve.

Në vetvete, kufizimi i tipeve të helikopterëve, ka efekt të drejtpërdrejtë në uljen e numrit të personelit mirëmbajtës, shpenzimeve për pajisjen e tyre me mjete pune etj, duke bërë të mundur që me të njëjtën vlerë (para) në dispozicion, të realizohet mirëmbajtje më e mirë për mjetet e tjera, duke rritur realisht numrin e mjeteve në gatishmëri.

Zëvendësimin gradual me helikopterë të rinj, nëpërmjet vlerësimit teknik për heqjen nga përdorimi të mjeteve që kanë plotësuar ciklin jetësor. Zëvendësimi i helikopterëve të vjetër paraqitet si domosdoshmëri ekonomike, pasi kosto e mirëmbajtjes së tyre në vite rritet ndjeshëm, duke kaluar vlerën e blerjes së mjetit dhe duke bërë të paleverdishëm mirëmbajtjen e mëtejshme të tyre. Ndërkohë, blerja e helikopterëve të rinj do të sjellë jo vetëm reduktimin e kostos financiare të mirëmbajtjes së tyre, por do të rrisë/garantojë ndjeshëm cilësinë dhe kapacitetet operacionale të kryerjes së misioneve/detyrave të tyre.

Mirëmbajtja e mjeteve dhe përgatitja e personelit, të orientohet drejt marrëveshjeve shtetërore me vendet e NATO-s, me qëllim, jo vetëm uljen e çmimit, por edhe shmangien e abuzimeve të mundshme.

Menjëherë

6. Gjetje. Nga auditimi i pasqyrës financiare te Komandës së Forcave të Armatosura, si dhe nga verifikimi në terren nga grupi i auditimit në Bazën Ajrore, Farkë, u konstatua se është bërë ndërtimi i veprës me objekt "Ndërtim Hangar Mirëmbajtje për Helikopterët" në vlerën 70,025,172 me TVSH, ku është likuiduar subjekti për vlerën **67,897,522 lekë me TVSH**, i cili nuk është marrë ende në dorëzim. Hangari deri në momentin e auditimit në terren nuk përdorej madje kishte pësuar dhe dëmtime nga kushtet atmosferike nga erërat e

forta ishte dëmtuar mbulesa e sipërme dhe vetrata anësore e hangarit, ku si rezultat i kësaj gjendjeje të gjithë helikopterët që ishin planifikuar për t'u strehuar momentalisht brenda këtij hangari janë alokuar në ambientet e jashtme të bazës, pavarësisht se nga baza ishin marrë masa për sigurinë fizike të tyre. Ambienti i jashtë për helikopterët, ndikon negativisht në pjesët e tyre fizike. Kontrata dhe projekti është i papërfunduar, ku zërat janë ngelur pa realizuar dhe punimet që kërkohen për përfundimin e objektit janë: *punime për instalimin e sistemit të ajrit të komprimuar së bashku me furnizimin dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e sistemeve hidrosanitare dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e pajisjeve të hapjes e të mbylljes së dyerve; punimet për instalimin dhe vendosjen e sistemit elektrik; punime për lyerjen e hangarit me bojë si dhe të dyerve.*

Për sa më sipër rikërkojmë:

Ministria e Mbrojtjes të marri masat që të planifikojë buxhet shtesë për përfundimin e veprës e cila nuk është funksionale dhe i ka kushtuar buxhetit të shtetit deri tani në shumën 67,897,522 lekë me TVSH.

Menjëherë

11. Gjetje: Nga auditimi në terren në Bazën Detare në Pashaliman dhe informacionit të marrë mbi gjendjen e anijeve në portet detare u konstatua se nga 46 mjete lundruese gjendje , 38 prej tyre janë jashtë përdorimi dhe 16 gjendje gatishmërie të ankoruara në portet e Pashaliman, Durrës, Bishpall, Rroguzë, Shëngjin. Nga 38 anijet të dala jashtë përdorimi, për 25 anije është bërë kategorizimi nga Komisioni i Posaçëm i Kategorizimit, për kalimin e tyre në muze, skrap si dhe për shitje për përdorim jo ushtarak, ndërsa për 13 anije të tjera nga KPK nuk është marrë asnjë masa për kategorizimin e tyre edhe pas propozimeve të herë pas herëshme nga Baza e Pashalimianit në MM. Gjithashtu u konstatua se dhe anijet të cilat janë kategorizuara për muze nuk plotësonin kushtet për muze dhe për to është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme KPK që të bëhet ri-kategorizimi i tyre pasi ato janë të mbytura në vendet të cilat janë të akostuara. Për disa të cilat janë kategorizuar muze realisht nuk ekzistojnë fizikisht, pasi janë shitur si skrap, dhe KPK i ka kategorizuar gabimisht në anije muze

Për sa më sipër rikërkojmë:

Komisioni i Posaçëm i Kategorizimit në MM të marrë masat për të vlerësuar gjendjen e anijeve dhe të bëjë kategorizimin dhe ri-kategorizimin e tyre, pasi zgjatja në kohë e procedurave rrit koston financiare në dëm të buxhetit të shtetit.

Menjëherë

12. Gjetje: Nga auditimi në terren në Bazën Detare në Pashaliman u konstatua se, pajisjet e vlerësuara për jashtë përdorimi të cilat mbahen tek parku i transportit nuk është marrë asnjë masë për shitjen e tyre si skrap ose për vazhdimin e procedurave të shkatërrimit sipas udhëzimit MM nr. 3 datë 13.03.2015/” Për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi”

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të realizuar procesin e shkatërrimit të këtyre aktiveve dhe nxjerrjen në ankand për shitje si skrap.

Menjëherë

14. Gjetje: Nga verifikimi në terren i grupit të auditimit të realizuar në bazën ajrore në Farkë u konstatua se nga 25 helikopter të regjistruara në asete të Top-i i Bazës Ajrore, në gjendje gatishmërie për fluturim ishin pesë. Të gjithë helikopterët e tjerë kërkonin punime mbi 1-vit, ku për 13 prej tyre nuk ishte planifikuar buxhet që nga viti 2014, ndërsa për pjesën tjetër ishin në provë vlerësimi, duke shkaktuar situatë jo të favorshme për gatishmërinë ushtarake dhe civile

Për sa më sipër rikërkojmë:

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të marrë masa për ngritjen e grupit të punës që të bëjë vlerësim e gjendjes aktuale të këtyre helikopterëve duke i ndarë në kategori ato që janë për riparim dhe ato që janë për dalje jashtë përdorimi. Mbas procesit të vlerësimit të marri masat për të vazhduar procedurat e mëtejshme nëse duhet shkatërruar, shitur për skrap apo të kalojnë si mjete muzeale në ambiente të përcaktuara nga MM.

B. REKOMANDIME PËR MASA ZHDEMTIMI

1. Gjetje Në përgjithësi vlerat mujore të qirave të apartamenteve të përfaqësive dhe atasheve ushtarakë, janë të njëjta dhe kanë qëndruar për vite me radhë konstante të pa ndryshuara. Por në veçanti vlera mujore të qirasë së apartamenteve të Atasheut Ushtarak në SHBA dhe Përfaqësuesit Ushtarak në Kroaci kanë ndryshuar ndjeshëm duke u rritur në vlerë. Konkretisht:

-Atasheu Ushtarak në SHBA, ka pasur kontratë të lidhur për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 2,900 USD. Në vitin 2017, kjo kontratë qiraje është ndërprerë për shkak të zëvendësimit të Atasheut të parë dhe ardhjes së Atasheut të ri, i cili me miratim të Sekretari i Përgjithshme dhe më pas të Ministrit të Mbrojtjes ka lidhur kontratë tjetër për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 4,425 USD. Pra vlera e qirasë në muaj është rritur rreth 152% dhe që nga lidhja e kontratës Korrik 2017 deri në Korrik 2020 kemi rritjen e shpenzimeve në dëm të buxhetin të shtetit që shkon në shumën **54,900 usd**.

-Përfaqësuesi ushtarak në Kroaci, ka pasur kontratë të lidhur për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 900 euro. Në Gusht 2016 kjo kontratë qiraje është ndërprerë për shkak të zëvendësimit të Përfaqësuesit të mëparshëm dhe ardhjes së Përfaqësuesit ushtarak të ri, i cili me miratim të Sekretari i Përgjithshme dhe më pas të Ministrit të Mbrojtjes ka lidhur kontratë për marrje apartamenti me qira me çmimin mujor 2,100 euro. Pra vlera e qirasë në muaj është rritur rreth 230% dhe që nga lidhja e kontratës Gusht 2016 deri Gusht 2019 kemi rritjen e shpenzimeve pa efektivitet në dëm të buxhetin të shtetit që shkon në shumën **43,200 euro**

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore **për shpërblimin e këtij dëmi në vlerën 54,900 usd dhe 43,200 euro**

Menjëherë

2. Gjetje: Nga auditimi u konstatua se, në katër përfaqësi ushtarake përveç shpenzimeve mujore për qiranë e apartamenteve, me miratimi i Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm, në zbatim të kontratave të lidhura është paguar dhe vazhdon të paguhet qira mujore edhe për përdorimin e disa pajisjeve shtëpiake, në kundërshtim me VKM, 305, date 12.03.2008 dhe Udhëzimin nr. 6, datë 02.05.2014, “Për disiplinimin e fondeve buxhetore ne funksion te veprimtarisë se Atasheve & Përfaqësuesve Ushtarake”. Në asnjë nga kontratat e lidhur për marrjen me qira të pajisjeve shtëpiake nuk ndodhen të bashkëlidhur lista me inventarin e pajisjeve që janë marrë me qira.

Në pikën 1 të VKM, 305, date 12.03.2008 dhe pikën f, gj të Udhëzimit nr. 6, datë 02.05.2014 të sipërcituar përcaktohen qartësisht kategoritë e shpenzimeve që do të përballohen nga buxheti i MM dhe konkretisht, në germën f) përcaktohet se, mbulohen “shpenzimet **për qira apartamenti dhe mirëmbajtje**” dhe në germën g) përcaktohet se, mbulohen “shpenzimet për pajisje shtëpiake”.

Duket qartë se VKM, 305, date 12.03.2008 nuk përcakton se, buxheti i shteti mbulon shpenzime qiraje për përdorim pajisje shtëpiake, por vetëm shpenzime qira apartamenti, ndërsa për pajisjet përcakton shpenzime për blerjen e tyre.

Vlera e përgjithshme e qirasë së paguar për këto pajisje shtëpiake në dëm të buxhetit të shtetit llogaritet 32,760 euro dhe 107,256 usd. Pra në rast se, këto pajisje do të bliheshin në zbatim të germës g të VKM dhe të germës gj të udhëzimit , vlera e blerjeve të tyre do të ishte disa hera më e vogël se pagesat e qirasë mujore dhe për më shumë këto pajisje do të ishin në pronësi të MM dhe do të përdoreshin për një kohë të gjatë nga përfaqësuesit ushtarake të tjerë. Konkretisht, paguhet qira për pajisjet shtëpiake nga këto përfaqësi:

- Përfaqësia ushtarake në Mons, T.M. ka paguar e vazhdon të paguaj qira çdo muaj duke filluar nga periudha Nëntor 2017 deri Nëntor 2017, me vlerën totale 14,760 Euro deri në fund të emërimit.

- Përfaqësia ushtarake në Gjermani, A.C. ka paguar e vazhdon të paguaj qira çdo muaj duke filluar nga periudha Gusht 2015 deri Gusht 2018, me vlerën totale 18,000 Euro deri në fund të emërimit.

- Përfaqësia ushtarake në Tampa/ShBA, J.M. ka paguar qira çdo muaj duke filluar nga periudha Gusht 2017 dhe do të vazhdoje të paguhet deri në Gusht 2019 që është edhe afati përfundimtar i kontratës, me vlerën totale për të gjitha periudhën e zbatimit të kontratës prej 19,080 usd.

- Përfaqësia ushtarake në Virginia/SHBA prej 3 vetash të emëruar për një periudhë 48 muaj kanë paguar e vazhdojnë të paguajnë qira çdo muaj në zbatim të kontratave dhe deri në përfundim të tyre, me vlerën totale 88,176 usd.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në vlerën 32,760 euro dhe 107,256 usd.

Menjëherë

3. Gjetje. Në disa procedura prokurimi të realizuara në zbatim të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” u konstatua se, AK ka hartuar dhe vendosur në Dokumentet e Tenderëve disa kërkesa të veçanta të pranimit kualifikimit në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik të cilat janë bërë shkak për s`kualifikimin e disa operatorëve të cilët kishin paraqitur oferta me te ultë se fituesit si dhe në disa procedura të tjera janë bërë s`kualifikime të pa drejta në kundërshtim me këto rregulla, të disa operatorëve ekonomik të cilët edhe këta kishin paraqitur oferta me te ultë se operatorët fituesit. Nga këto shkelje apo veprime dhe mosveprime të AK i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëmi ekonomik vlerën **35,650,903 lekë**. Konkretisht këto shkelje janë konstatuar në këto procedura prokurimi (*trajtuar më hollësisht në faqet 73-121 të Raportit Përfundimtar të auditimit*):

3.1. “Blerje pjesë këmbimi për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” e realizuar në vitin 2015, me fond limit në vlerën 45,442,738 lekë, shpallur fitues subjekti “A. COM.” dhe “S.CO” me vlerë oferte 44,823,868 lekë.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedurës, AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse disa kriteret të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar dhe përcaktuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet. Këto kërkesa janë hartuar teje të fryra, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Këto shkelje janë bërë shkaqe të cilat KVO i ka shfrytëzuar duke bërë vlerësime subjektive duke s`kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “A. G.” & “R..R.” me ofertë ekonomike më të ulët se operatori fitues. KVO nuk ju referua pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” për ti konsideruar këto mangësi devijime të vogla, me arsyetimin se: mungesa e një magazinë apo dyqani në funksion të realizimit të kontratës, mungesa e mjetit të transporti dhe mos punësimi 1 (një) inxhinieri mekanik nuk pengojnë operatorin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kësaj kontrate, sepse kjo kontratë është me objekt blerje pjesë këmbimi të cila realizohet fare mirë nga çdo tregtar i vogël, i mesëm apo i madh, pa pasur dyqan, makine apo të punësuar inxhinierë mekanik. Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 1,293,043 lekë, me TVSH.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në *shumën 1,293,043 lekë*.

Menjëherë

3.2. Gjetje. “Blerje artikuj ushqimorë për nevoja të KFD, Loti I” dhe “Blerje artikuj ushqimorë për nevoja të PU, Loti II”, të realizuar në vitin 2015. Loti I, me fond limit në vlerën 20,926,909 lekë është shpallur fitues B. “Sh.” & “E.M.” me vlerë oferte 20,543,319 lekë. Loti II me fond limit në vlerën 3,427,318 lekë, është shpallur fitues operatori “Sh.” me vlerë oferte 3,377,005 lekë.

-Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit në të dy Lotet, KVO ka s’kualifikuar operatorin “N.” dhe operatori “K.” nga të dy Lotet, sepse nuk kanë paraqitur lejen higjieno-sanitare për ambientin ku ushtron aktivitetin prodhim/tregtim buke dhe leje sanitare-veterinare për asnjë nga ambientet të cilat i ka deklaruar si vende të ushtrimit të aktivitetit. Mirëpo mungesa e këtyre dokumenteve nuk e pengojnë që këta operatorë të përmbushin me sukses kontratën e furnizimit. Të dy operatorët, kanë paraqitur licencë të kategorisë II.1.A “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve” dhe licencë të kategorisë II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore”, çka tregojnë se, furnizimin e artikujve ushqimorë mundë ta bëjnë direkt nga prodhuesi ose nga tregtarët e shumicës për të AK, pa qenë nevoja që artikujt ushqimorë ti ruajnë në magazina apo dyqanet e tyre, mjafton që furnizimi të bëhet më kamioni frigoriferik, për të cilët të dy operatorët kanë paraqitur dokumente që e vërtetojnë që i kanë këto makineri së bashku me lejen higjieno-sanitare të tyre. Pra mos paraqitja e lejet higjieno-sanitare dhe veterinare për vendet dhe ambientet e tregtimit nuk pengojnë furnizimin e produkteve ushqimorë. Si pasojë e s’kualifikimeve në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik i është shkaktuar buxhetit të shteti dëm ekonomik *në vlerën 4,838,636 lekë, me TVSH*, respektivisht, 4,080,226 lekë, në lotin I dhe 758,410 lekë në Lotin II. (Kjo vlerë llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “N.” me vlerën e ofertës së operatorit fitues “Sh...” & “E.M.” për lotin e I dhe operatorit fitues “Sh...” për lotin e II).

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në *shumën 4,838,636 lekë*.

Menjëherë

3.4. Gjetje. “Shtesë depo karburanti JET A1, në Bazën Ajrore Farkë” e realizuar në vitin 2015, me fond limit në vlerën 34,434,130 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse disa kriteret të veçanta kualifikuese nuk janë hartuar dhe përcaktuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Ndër të tjera është e kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: 1 elektrikist, 1 hidraulik, 1 mekanik dhe 2 saldator, të pajisur me dëshmi kualifikimi (diplomë shkolle certifikata kualifikimi, trinime) dhe duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën janar – maj 2016). Vendosija e këtyre kërkesave është bërë shkak për s’kualifikim të padrejtë të 2 operatoreve pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht, në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. KVO, ka kualifikuar vetëm operatori ekonomik “BE - IS” i cilët është shpallur edhe fitues me ofertën ekonomike në vlerën 29,264,241 lekë dhe ka s’kualifikuar 3 operatorët e tjerë, dy nga të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulta se operatori fitues. Gjate shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, KVO ka përdorur dy standarde në vlerësimin e kapaciteteve teknike të ofertuesve sepse, nga njëra anë ka s’kualifikuar me pa të drejtë operatorët ekonomik “M./S” dhe “K...” të cilët kanë paraqitur ofertat më të ulta se operatori fitues, me pretekstin se kanë mangësi, por këto mangësi janë

shumë të vogla dhe nuk e pengojnë ekzekutimin me sukses të kontratës apo janë mangësi të sajuara nga vetë KVO siç është rasti i formatit të deklaratës së konfliktit të interesit të operatorit “M/S”. Nga ana tjetër ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues operatorin “B..” i cili edhe ky, ka paraqitur dokumentacionin me mangësi të vogla si të dy operatorët e tjerë. Nga ky veprim i është shkaktuar buxheti të shtetit dëm ekonomik i cili llogaritet si diferencë e ofertës së operatorit “B...” të shpallur fitues dhe dy operatorëve të tjerë të s’kualifikuar në kundërshtim me LPP. Konkretisht, Operatori ekonomik “M/S” dhe Operatori ekonomik “K..” duhet të ishin kualifikuar për fazën tjetër atë të shqyrtimit ekonomik sepse i plotësonin të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në DT. Dhe nga shqyrtimi i ofertës ekonomike, operatori ekonomik “K..” duhej të shpallej fitues sepse kishte paraqitur ofertën më të ulët se dy operatorët e tjerë të kualifikuar. Për pasojë, diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues “B...” me vlerën e ofertës së operatorit “K..” përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit e cila llogaritet në vlerën 8,931,708 lekë, me TVSH ..

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 8,931,708 lekë.

Menjëherë

3.5 Gjetje. “Rikonstrukcion i njejeve h/sanitare të godinës së stërvitjes individuale bazë SIA dhe SIB në Shkollën e Trupës, Bunavi Vlorë i ndarë në dy Lote” të realizuar në vitin 2016. Loti I, me fond limit në vlerën 15,220,775 lekë dhe Loti II me fond limit në vlerën 18,091,502 lekë. Ne të dy lotët është shpallur fitues operatori “K.I.” për Lotin I me vlerë oferte 14,369,236 lekë dhe për Loti II me vlerë oferte 17,251,782 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse në DT të të dy lotëve ka vendosur disa kriteret të veçanta kualifikuese të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Konkretisht, ndër të tjera është kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: “hidraulik, mekanik, teknik ndërtimi, specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, punonjës të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi për; montim skeleri/suvatim fasade/lyerje fasade/parapet tarrace, etj. Të gjithë këta punonjës duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi, diplom shkolle, certifikata kualifikimi, trainime, etj, dhe duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar (Janar – Maj 2016). Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak për s’kualifikim të padrejtë të 4 operatoreve pjesëmarrës në procedurën prokurimit në të dy lotet. Në tenderin e zhvilluar në datën 22.07.2016 në të dy lotet kanë marrë pjesë 6 operatore ekonomik të njëjtë, janë s’kualifikuar nga të dy lotët 5 operatorët, 4 nga të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulta se operatori fituesit për të dy lotët. Nga të 5 operatorët e s’kualifikimit përveç 1 operatori (“E...”) që është s’kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik, 4 operatorët e tjerë janë s’kualifikuar vetëm për mos plotësim të kriterëve të veçanta që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e dokumentacionit për të vërtetuar se, kanë pjesë të stafit punonjës të kualifikuar të sipërcituar. Pra nuk kanë paraqitur dëshmi, certifikatë ose diplomë që të vërtetojë kualifikimin profesional të tyre, apo dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Mirëpo, siç u tha, këto kriteret të veçanta janë vendosur të ekzagjeruara sepse për të vërtetuar që operatorët kanë eksperience në këtë fushë është kërkuar dhe këta operator kanë paraqitur kontratat e ngjashme të cilat vërtetojnë më së miri se, kanë kryer me sukses gjatë tre viteve të fundit punë të ngjashme të kësaj natyre. Për me tepër duke ju referua pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” këto mangësi konsiderohen lehtësisht devijime të vogla, me arsyetimin se, nuk e pengojnë operatorin dhe nuk ndikojnë në

ekzekutimin e kontratës, sepse kjo kontratë është me objekt të thjeshtë “Rikonstruksion i nyjeve h/sanitare...” dhe kryerja e këtyre punimeve nuk kërkon punëtorë të pajisur me certifikata, diploma apo orë trajnimi (rikonstruksioni i tualeteve kryhet brenda ndërtesës dhe nuk kanë nevojë për punonjës të trajnuar për punime lartësie, etj). Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik i cili llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit fitues “K..I..” dhe vlerës së ofertës së operatorëve të tjerë të s’kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, këta operatorë duhet të ishin kualifikuar për fazën tjetër atë të shqyrtimit ekonomik dhe pas shqyrtimit të ofertave ekonomike, duhej të shpallej fitues operatori ekonomik “K... C...” sepse kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatori fitues dhe operatorët e tjerë. Për pasojë, diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues “K.. I..” me vlerën e ofertës së operatorit “K.Co..” përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit e cila llogaritet në vlerën 8,734,189 lekë, me TVSH, respektivisht, 5,419,408 lekë për lotin I dhe 3,314,781 lekë për Lotin e II.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 8,734,189 lekë.

Menjëherë

3.6. Gjetje. “Ndërtim depo karburanti në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau Dejës, Shkodër” e realizuar në vitin 2016, me fond limit në vlerën 12,870,092 lekë.

Procedura e prokurimit është zhvilluar në datën 16.03.2016 dhe kanë marrë pjesë 2 operatorët ekonomik. KVO ka kualifikuar operatorin “B..” i cili është shpallur fitues, me ofertën ekonomike në vlerën 12,613,554 lekë dhe ka s’kualifikuar operatorit tjetër “K..” i cili ka ofertën me të ulët se fituesi. S’kualifikimi i këtij operatori është bërë sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e disa kriterëve të veçanta për kualifikim si: deklaratë mbi shoqërinë prodhuese dhe autorizim e lëshuar nga prodhuesi se do të furnizojë operatorin ekonomik me rezervuarët/depozitat sipas projektit, si dhe dokumente me anë të të cilave të vërtetojë eksperiencën e prodhuesit të deklaruar në prodhimin e rezervuarëve/depozitave të karburantit (kontrata, fatura shitje, etj.). Por lidhur me dokumentacionin e sipërcituar, ofertuesi ka paraqitur një deklaratë “*Rezervuarët e karburantit që do të instalohen do të prodhohen nga shoqëria jonë me eksperiencë në këtë fushë pasi ka ndërtuar 2 karburante*”. KVO, nisur nga deklarata e paraqitur, verifikoi në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar dhe rezultoi se, ofertuesi nuk ka si objekt të ushtrimit të aktivitetit prodhimin e depozitave të karburantit ose depozitave të gazit dhe në këto kushte, operatori ekonomik s’kualifikohet. Por, nga auditimi mbi ligjshmërinë e këtij s’kualifikimi rezultoi se, ky operatorë është s’kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi pretendimi i KVO nuk ka të bëjë me objektin e veprimtarisë së këtij operatori sepse, prodhimi i depozitave të karburantit ose depozitave të gazit apo i depozitave të çfarë do lloji nuk janë veprimtari me vete, por përfshihen në veprimtarinë e punëve të ndërtimit të cilat ofertuesi sipas Ekstraktit QKR kryhen veprimtari, ndërtimi, montimi, prodhime materiale ndërtimi, ujësjellësa, silose kulla uji, kulla beton arme, metalike, etj. Për më tepër, eksperiencën në prodhimin e depozitave të karburantit ose depozitave të gazit dhe instalimin e tyre ky operator e vërteton me kontratën e ngjashme që ka paraqitur në sistemin elektronik. Konkretisht ka paraqitur, kontratën për ndërtimin e kompleksit të shërbimeve (Autogrill) në Blinisht në rrethin Mirditës (autostrada Durrës-Kukës). Pra nga njëra anë kjo kontratë e konsideron në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe nga ana tjetër nuk merr në konsideratë furnizimin dhe vendosjen e depozitave të karburantit të kryera sipas kësaj kontrate, por ngre pretendimin me pa të drejte se nuk ka të regjistruar si, objekt të ushtrimit të aktivitetit prodhimin e depozitave të karburantit ose depozitave të gazit. Nga ky veprim i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 1,432,456 lekë. Ky dëm, llogaritet nga diferenca e vlerës së ofertës të operatorit fitues “B..” me vlerën e ofertës të operatorit “K..” të s’kualifikuar në kundërshtim me LPP.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 1,432,456 lekë.

Menjëherë

3.7. Gjetje. “Rikonstruksion i objektit dykatësh, ish biblioteka e KDS-së me destinacion Qendër e Ekselencës” të realizuar në vitin 2017, me fond limit 68,007,365 lekë, me operator fitues “I.” me vlerë oferte 45,400,279 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse në DT ka vendosur disa kritere të veçanta kualifikuese të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Ndër të tjera është kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: punëtor që përmbush kriteret për të qenë *koordinator/përgjegjës për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit; punëtor të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi; punëtor të kualifikuar* si: 2 teknik ndërtimi, 3 elektrikist, 3 hidraulik, 1 mekanik, 2 saldator dhe 3 bojaxhi. Të gjithë këta punëtor duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi, diplom shkolle, certifikata kualifikimi, trainime, etj, dhe duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2016 - korrik 2017. Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak për s`kualifikim të padrejtë të 1 (një) operatori pjesëmarrës në procedurën prokurimit. Konkretisht, në tenderin e zhvilluar në datën 22.9.2017 kanë marrë pjesë 8 operatore ekonomik, janë s`kualifikuar 4 operatorë, nga të cilët B. “E...” & “R...” është s`kualifikuar se, nuk plotëson kriteret të veçanta që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e dokumentacionit të sipërcituar për të vërtetuar se, ka pjesë të stafit punëtor të kualifikuar (*bojaxhi, hidraulik, punëtor të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi, për sigurinë dhe shëndetin*, etj.) si dhe njëri nga anëtarët e shoqërisë operatori “R...” nuk disponon gjendje parash në llogari të tij në vlerën e kërkuar në dokumentet e tenderit dhe në raport me përqindjen e pjesëmarrjes. Por, siç u tha më sipër, kriteret e veçanta që lidhen me punëtorët e kualifikuar, janë vendosur të ekzagjeruara sepse për të vërtetuar që operatorët kanë eksperience kanë paraqitur kontratat e ngjashme të cilat vërtetojnë më së miri se, kanë realizuar me sukses gjate tre vitet e fundit punë të ngjashme të kësaj natyre. Po kështu edhe arsye tjetër e s`kualifikimi se, operatori “R...” nuk disponon gjendje parash në llogari të tij në vlerën e kërkuar dhe në raport me përqindjen e pjesëmarrjes është mangësi e pa përfillshme sepse vetë AK pothuajse në të gjitha procedurat e prokurimeve si, civilet, ushtarake dhe sekretet të kufizuara të realizuara më parë apo pas kësaj procedure nuk ka kërkuar në DT që operatorët duhet të kenë gjendje para në vlerën 10% të fondit limit. Ndërsa në këtë procedurë e kërkon këtë kriter e cila bëhet edhe shkak për s`kualifikim. Duhet theksuar se, anëtari tjetër i kësaj shoqërie “E...” i cili është edhe lideri i shoqërisë ka gjendje në llogari sa dyfishi i parave të kërkuara në DT, në këto kushte kjo kërkesë e pa plotësuar nga operatori “R...”, plotësohet nga anëtari tjetër. Për me tepër, nisur nga vlera e ofertës më të ulët, në referim të pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” këto mangësi konsiderohen lehtësisht devijime të vogla se, ato nuk pengojnë dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, pasi kjo kontratë është me objekt të mirënjohur, rikonstruksion godinë 2 katesh. Punimet e rikonstruksionit realizohen me punëtorë të thjeshtë pa qene nevoja të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi apo trajnime për lartësi deri në dy kate, etj, etj. Edhe kërkesa që, këta punëtorë, domosdoshmërisht duhet të ishin të punësuar nga operatorët për një periudhë një vjeçare të mëparshme, është kërkesë shumë diskriminuese, dhe pothuajse asnjë operatore që është në treg nuk e plotëson sepse një punëtorë i caktuar p.sh, saldatori, hidrauliku, bojaxhiu, etj, mund të punojnë sipas nevojës që kanë operatorët për punë të caktuar dhe me kohe të pjesshme apo me nenkontraktim pa qenë e nevoja që këta të jenë detyrimisht të punësuar për një periudhe një vjeçare . Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik

në vlerën 4,081,880 lekë, me TVSH. Ky dëm llogaritet nga diferenca e vlerës së ofertës të operatorit fitues “I...” me vlerën e ofertës të operatorit “E..”&”R..”, i cili është s`kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik”.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në shumën 4,081,880 lekë.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE.

2. Gjetje: “Kompletimi me uniforma stërvitje e materiale të tjera pjesë e kësaj uniforme për strukturat ushtarake të FA-së”, për periudhën 2018-2021, me fond limit në vlerën 1,483,395,642 lekë, realizuar në vitin 2017.

Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes është ngritur grupi i punës për studimin e disponueshmërisë dhe analizës së kostos për blerjen e uniformave të stërvitjes e materialeve të tjera, pjesë e kësaj uniforme për strukturat ushtarake të Forcave të Armatosura. Grupi i punës pasi studioj faqe të ndryshme të ëeb-siteve të disa kompanive të huaja prodhuese të cilat operojnë në këtë fushë vendosi të dërgoj në rrugë zyrtare dhe elektronike kërkesën për çmime dhe disponueshmëri 7 kompanive. Kërkesës për çmim dhe disponueshmëri i janë përgjigjur të 7 kompanitë, duke sjellë çmimet e tyre. Gjashtë nga këto kompani kanë dërguar çmimet për të gjithë artikujt e kërkuar, ndërsa kompania “K..s.r.l”, Itali ka dërguar çmimet vetëm për artikujt e këpucëve të cilat i kishte paraqitur me çmime më të ulta se, të gjashtë kompanitë e tjera. Grupi i punës vendosi që çmimet për llogaritjen e fondit limit të jenë mesatarja e, çmimit të kontratës së mëparshme; çmimit mesatares së nxjerrë nga kompanitë /distributorët online; çmimit mesatar i kompanive të zgjedhura për çmim dhe disponueshmëri dhe në përfundim, llogariti fondin limit në vlerën 1,483,395,642 lekë. Po kështu ka sugjeruar që procedura e prokurimit të zhvillohet e “Kufizuar” me pjesëmarrjen e të 7 kompanive që u kërkojë çmime dhe disponueshmëri. Në vijim, është miratuar prokurimi i këtij projektit nga Ministri i Mbrojtjes dhe nga DSM është dërguar i gjithë praktika dokumentare e prokurimi në DAP për të vijuar me zhvillimin e procedurës së prokurimit. Kjo Drejtori, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dërguar i ka kërkuar DSM disa sqarime dhe plotësim dokumentacionit të kësaj procedure. Ndër sqarimet me kryesore është: *“shoqëria “K..s.r.l”, Itali e cila ka dhënë ofertë për artikujt që zënë një vlerë përafërsisht 30% të fondit limit, çka vë në diskutim edhe mundësinë e nën kontraktimit për pjesën tjetër të artikujve, pasi referuar “Kushteve të përgjithshme të Kontratës”, pjesë e DST që aplikon AK, nën kontraktimi lejohet për një vlerë jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës....”?* DSM, mori në konsideratë këtë sqarim dhe bëri një ndryshim në propozimin e mëparshëm duke mos e ftuar këtë shoqëri për të paraqitur ofertën e saj, pra nga 7 kompani ftoi për të paraqitur ftesën për ofertë vetëm 6 kompani. Mirëpo argumentim i AK, për mos të ftuar kompaninë “K..s.r.l”, Itali në procedurën e prokurimi është bërë në interpretime të gabuara të VKM nr.521, date 8.8.2007 i ndryshuar, sepse, siç u trajtua më lartë, sipas pikës 1 të kreut VII të kësaj VKM që bënë fjalë për “Ekzekutimin e kontratës”, nënkontraktimi behet nga operatori që del fitues dhe që me dorëzimin e ofertave duhet të deklarojë punët shërbimet ose mallrat që ka për qëllim të nënkontrakttojë në rast se ai do të shpallet fitues. Pra nënkontraktorët nuk marrin pjesë në konkurrim (prokurim) por ofertuesi duhet ta deklarojë që një pjesë të kontratës do ta japi me nën kontraktim. Pra, kompanisë “K...s.r.l”, Itali, duhej ti dërgohej ftesa për ofertë, dhe në rast se, ajo gjykonte për të marrë pjesë në prokurim, për artikujt e tjerë që nuk kishte paraqitur çmime dhe disponueshmëri, fare mirë mundë të bënte bashkim operatorësh, ashtu siç ka bërë edhe kompania fituese të cilës i është dërguar ftesa për ofertë e vetme, por në prokurim është paraqitur si bashkim i tre operatorëve dhe KVO e ka shpallur fitues edhe pse VKM nr. 521, date 8.8.2, ndryshe nga

rregullat e prokurimeve civile nuk parashikon rastet e bashkimit të shoqërive në një të shoqëri të vetme. Konkretisht, në procedurën e prokurimit të zhvilluar në datën 18.12.2017, paraqitën dhe dorëzuar oferta vetëm 3 (tre) Kompani: “L... S.R.L” me ofertë në vlerën 1,481,013,520 lekë, B. “D...SRL &”T.. P., Y.. T.. ve D San.Tic A.S” &”M..” & A..”, me ofertë në vlerën 1,479,495,980 lekë dhe “A..G..S.P.A” me ofertë në vlerën 1,481,173,150 lekë. Është shpallur fitues me të cilin është lidhur dhe kontrata e furnizimit B. “D... SRL &”T...P...”, “Y...T... ve D San.Tic A.S “&”M..” & “A..”, me ofertë në vlerën 1,479,495,980 lekë, pa TVSH. Por, për shkak të mos dërgimit të i ftesës për ofertë të kompanisë “K...s.r.l”, Itali, grupi i auditimit mori në analizë, çmimet dhe vlerat e artikujve të këpucëve, sipas ofertës fituese dhe i krahasoi me çmimet e kompanisë “K...s.r.l”, Itali të paraqitur në kërkesën për çmime dhe disponueshmëri dhe rezultoi se, çmimet e artikujve të këpucëve të kësaj kompanie ishin rreth 80 milion lekë më të ulta se çmimet e artikujve të këpucëve të ofertës fituese B. “D...SRL &T.. P., Y...T.. ve D.San.Tic A.S &M...& A...”. Për pasojë nga mos marrja pjesë në mënyrë të padrejtë të kompanisë “K...s.r.l”, Itali mund të ishte ulur rritur kosto e blerjes së këtyre materialeve ushtarake ***në vlerën rreth 80 milion lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 121-128 të Raportit Përfundimtar të auditimit)***.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore ***në vlerën rreth 80 milion lekë***.

Menjëherë

3.Gjetje. Nga auditimi i pasqyrës financiare te Komandës së Forcave të Armatosura, si dhe nga verifikimi në terren nga grupi i auditimit në Bazën Ajrore, Farkë, u konstatua se është bërë ndërtimi i veprës me objekt “Ndërtim Hangar Mirëmbajtje për Helikopterët” në vlerën 70,025,172 me TVSH, ku është likuiduar subjekti për vlerën 67,897,522 lekë me TVSH, i cili nuk është marrë ende në dorëzim. Hangari deri në momentin e auditimit në terren nuk përdorej madje kishte pësuar dhe dëmtime nga kushtet atmosferike nga erërat e forta ishte dëmtuar mbulesa e sipërme dhe vetrata anësore e hangarit, ku si rezultat i kësaj gjendjeje të gjithë helikopterët që ishin planifikuar për tus strehuar momentalisht brenda këtij hangari janë alokuar në ambientet e jashtme të bazës, pavarësisht së nga baza ishin marrë masa për sigurinë fizike të tyre. Ambienti i jashtë për helikopterët, ndikon negativisht në pjesët e tyre fizike. Kontrata dhe projekti është i papërfunduar, ku zërat janë ngelur pa realizuar dhe punimet që kërkohen për përfundimin e objektit janë: *punime për instalimin e sistemit të ajrit të komprimuar së bashku me furnizimin dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e sistemeve hidrosanitare dhe montimin e pajisjeve; punime për instalimin e pajisjeve të hapjes e të mbylljes se dyerve; punimet për instalimin dhe vendosjen e sistemit elektrik; punime për lyerjen e hangarit me bojë si dhe të dyerve (trajtuar më hollësisht në faqet 144-147 të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe lidhet dhe me rekomandimin e lenë më lartë në piken Ç.I.12).*

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përfundimin e veprës e cila nuk është funksionale dhe i ka kushtuar buxhetit të shtetit deri tani në shumën 67,897,522 lekë me TVSH. Nëse nuk merren masa për të përfunduar objektin si dhe marrjen në dorëzim, ***shuma prej 67,897,522 lekë përbën dëm ekonomik i parikuperueshëm në dëm të buxhetit të shtetit***.

Menjëherë

4. Gjetje. “Rikonstruksion i mensës së pilotëve në Bazën Ajrore, Fark Loti II”, të realizuar në vitin 2016, me fond limit në vlerën 9,824,170 lekë, me operator të shpallur fitues “K...” me vlerë oferte 7,538,095 lekë.

AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse në DT ka vendosur disa kritere të veçanta kualifikuese të cilat nuk janë hartuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet, janë

hartuar, kufizuese dhe penguese dhe nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, shmangin konkurrencën, nuk sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet operatorëve ekonomik. Ndër të tjera është kërkuar që, operatorët ekonomik duhet të dëshmojë se kanë të punësuar punëtor të kualifikuar si: “hidraulik, mekanik, punëtor/specialist ndërtimi, bojaxhi, etj. Të gjithë këta punonjës duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi, diplom shkollë , certifikata kualifikimi, trainime, etj, dhe duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar (janar – qershor 2016). Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak për s’kualifikim të padrejtë të 3 operatoreve pjesëmarrës në procedurën prokurimit. Konkretisht, në tenderin e zhvilluar në datën 05.09.2016 kanë marrë pjesë 9 operatore ekonomik, janë s’kualifikuar 3 operatorë vetëm se nuk kanë plotësuar kriteret të veçanta që kanë të bëjnë me mosparaqitjen e dokumentacionit që të vërtetojnë se, operatorët kanë pjesë të stafit punonjës të kualifikuar (“elektracist, hidraulik, mekanik”, etj.) si: dëshmi, certifikatë ose diplomë që të vërtetojë kualifikimin profesional të tyre, apo dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI . Mirëpo, këto kriteret të veçanta siç u tha janë vendosur të ekzagjeruara dhe në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse këta operatorë për të vërtetuar se, kanë eksperience në këtë fushë duhet të paraqisnin dhe i kanë paraqitur kontratat e ngjashme, të cilat janë mese të mjaftueshme për treguar se, këto operatorë kanë kryer më parë me sukses punë të ngjashme të kësaj natyre. Duke ju referua edhe pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” këto mangësi të, konsiderohen lehtësisht devijime të vogla dhe nuk e pengojnë operatorin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, sepse objekti i kontratës është “Rikonstruksion mense” dhe kryerja e punimeve nuk kërkon punëtorë të kualifikuar të pajisur me certifikata, dëshmi apo diploma shkollë, por mjafton që të kenë kontratë pune dhe të jenë të regjistruar në sigurime shoqërore. Nga këto veprime i është rritur kosto e buxhetit të shtetit në vlerën 920,408 lekë, me TVSH, e cila llogaritet nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues me diferencën e vlerës së ofertës së operatorit “SH...” të s’kualifikuar padrejtësisht i cili kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatorët e tjerë që duheshin kualifikuar.

Për sa më sipër rikërkojmë:

MM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore në shumën 920,408 lekë.

Menjëherë

II. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë, të vitit 2019.

21. MINISTRINË E MBROJTJES (tematik)

Nga auditimi tematik i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes (MM), për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 1249/1, datë 30.11.2018 konstatohet se:

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria e Mbrojtjes, ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH është vënë në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, duke dërguar planin e veprimeve, si dhe duke përcaktuar pranimin (ose jo) të rekomandimeve të KLSH-së

- Nga ana e subjektit nuk është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit duhej të përcillej plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna,

strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Masa për shpërbllim dëmi janë lënë **5** rekomandime për shumën 53,116 mijë lekë të cilat janë pranuar nga MM dhe janë në proces zbatimi. Për zbatimin e tyre Ministria e Mbrojtjes ka marrë hapat e mëposhtme:

Sekretari i Përgjithshëm i MM me shkresën nr. 575 datë 28.01.2019, ka dërguar Drejtorit të kabinetit të bankës së Shqipërisë një kërkesë për informacion në lidhje me subjektin “D.. C...&C...”, nëse është i pajisur me licencë për të ushtruar aktivitet financiar të Faktoringut gjatë periudhës 2013.

- me shkresën nr. 638/1 datë 06.02.2019, Banka e Shqipërisë i kthen përgjigje se ky subjekt nuk ka qene dhe nuk është i licensuar pranë bankës së Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë financiare të faktoringut

- ministria me shkresën nr. 2512 datë 18.04.2019 i kërkon Bankës së Shqipërisë interpretim të dytë në lidhje se nëse, duhet që shoqëritë të pajisen me licencë nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar aktivitet financiar të Faktoringut, para se të blejë detyrimet e një pale të tretë, ndaj një shoqërie që ofron shërbimin e telefonisë, dhe a përbën blerje të një pale të tretë, nga një shoqëri e palicensuar nga Banka e shqipërisë, nga një kompani që ofron shërbime telefonike celulare?

Nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 2808/1, datë 20.05.2019 është kthyer përgjigje ne MM ku thuhet se:

Duke u bazuar në nenin 2 të ligjit nr. 9630, datë 30.10.2006 “Për faktoringun”, nuk mund të gjykojmë nëse kontrata faktoring e lidhur midis furnizuesit (kompania A...) dhe faktorit (shoqëria “D...C.. & C...”), i parashikon apo jo kushtet e mësipërme.

Edhe pse rekomandimet janë pranuar dhe konsiderohen në proces zbatimi, duke konsideruar “rëndësinë e çështjes”, **rikërkojmë përshejtimin** e realizimit të plotë brenda 3 mujorit të tretë të vitit 2019 si më poshtë:

Gjetje nga auditimi: Referuar pretendimeve dhe dokumenteve të shoqërisë përmbarimore “Dominus Collection & Consulting” të vënë në dispozicion të këtij auditimi, u evidentua:

Në vitin 2014, kjo shoqëri përmbarimore, është kontraktuar nga ish-kompania telefonike celulare A... për mbledhjen dhe rikuperimin e borxheve që MM i kishte kësaj kompanie deri në këtë periudhë. Ky borxh ishte akumuluar në vite, si rezultat i mos shlyerjes së detyrimeve që MM kishte me ish-kompaninë “A...” në zbatim të kontratave të lidhura mes tyre për shërbimin e telefonisë celulare. Në bazë të këtyre kontratave, MM ishte e detyruar të paguante çdo muaj detyrimin në baze të faturave që i dërgonte ish-kompania “A...” dhe në rast të mos shlyerjes së detyrimit, pas njoftimit të bërë, “A...” i linte e drejta e mbylljes së sinjalit dhe abonenti mund të merrte vetëm thirrjet hyrëse. MM, në zbatim të këtij kushti kontraktual, nuk ka likuiduar detyrimin në kohë, dhe në këto kushte, ish-kompania “A...” i ka konsideruar të zgjidhura kontratat dhe ka kërkuar në vazhdimësi MM, të shlyejë detyrimin përkatës sipas kontratave që ishin në fuqi.

Sipas kësaj shoqërie, pretendohet se, MM deri më sot, nuk ka likuiduar detyrimin dhe mbart një detyrim në total **53,116,286.60 lekë**.

Shoqëria përmbaruese “D.C.. & C..”, pas lidhjes së kontratës së shërbimit, me ish-kompaninë “A...” në vitin 2014 i është drejtuar MM në mënyre të vazhdueshme që, në zbatim të VKM, Nr. 50, datë 05/02/2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” duhet të shlyhej këto detyrime të prapambetura. Konkretisht, i është drejtuar me shkresat “njoftim detyrimi”: nr. 67/2, datë 18.06.2014; nr. 67/3, datë 14.07.2014; nr. 67/4, datë 29.07.2014; nr. 67/5, datë 05.12.2014, si dhe i ka dërguar, të gjitha faturat tatimore me listat dhe detyrimet përkatëse për çdo Njësi Varësi të

MM. *Po kështu e ka bërë me dije, në rast se, detyrimi nuk shlyhej në kohë, do ti drejtohej gjykatës për zgjidhjen e kësaj çështje, dhe se do të mbanin përgjegjësi për rritjen progresive të detyrimit, që do të vinte si pasojë e shpenzimeve gjyqësore, kamatëvonesave ligjore, tarifës përmbartimore, etj.* Por, nga ana e MM nuk u mor asnjë masë për shlyerjen e detyrimeve, duke vijuar rritjen e detyrimeve të reja.

Më pas në fund të vitit 2016, (po sipas shoqërisë), me marrëveshjen nr. 7574 date 01.12.2016, shoqëria "D.C.. & C.." shpk, ka blerë nga ish-kompania "A.." sot "T.. A..." sh.a të gjitha të drejtat për kërkimin e detyrimeve që të tretët i kanë pasur kësaj shoqërie sipas kontratave dhe faturave përkatëse, ku pjesë e këtij portofoli ishte edhe detyrimi i MM, i cili ishte ndjekur nga "D... C.. & C.." që në vitin 2014. Edhe mbas kësaj marrëveshje, MM është njoftuar disa here nga shoqëria duke i kujtuar që shlyerja e detyrimeve të prapambetura është bërë detyrim ligjor sipas VKM, Nr. 50, date 05/02/201. Por, përsëri nga MM nuk u mor asnjë masë për shlyerjen e këtij detyrimi.

Vlera e detyrimeve të pretenduar nga shoqëria e pa shlyer nga MM (sipas dokumenteve të shoqërisë) e akumuluar që nga viti 2005 deri në vitin 2012, është në totale 53,116,286.6 lekë, e cila sipas shoqërisë, përbëhet:

1. Nga vlera prej **2,884,778 lekë**, që janë detyrime që i përkasin vetëm aparatit të MM. Kjo vlerë përfaqëson detyrimet që kanë pasur ish-punonjës apo punonjës aktual të Administratës së Ministrisë që, në zbatim të VKM-së 343, datë 11.07.2002 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë", janë pajisur më numra celularë dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit (nga MM). Vlera e mbetur prej **50,231,500 lekë** nuk është e ndarë në mënyrë analitike, por përbëhet:

2. Nga një pjesë që Njësitë Vartëse (repartet ushtarake) i kanë pasur ish-kompanisë "A..", detyrime të papaguara për shërbimin e telefonisë fikse dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit.

3. Nga një pjesë detyrimeve të papaguara për ish-punonjës apo punonjës aktual të Njësitë Vartëse që në zbatim të VKM-së 343, datë 11.07.2002, janë pajisur më numra celularë dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit.

4. Nga një pjesë të detyrimeve personale (individuale) të papaguara të ish-punonjësve apo punonjësve aktual të gjithë sistemit të MM, shpenzimet e të cilëve nuk mbulohen nga buxheti i shtetit, por nga vetë punonjësi. Këtyre ish-punonjësve apo punonjësve aktual, u është mbajtur detyrimi nga paga, por ky detyrim nuk është derdhur nga strukturat përgjegjëse nëpërmjet thesarit në llogari të ish-kompanisë "A..". Kjo vërtetohet me disa listë pagesa të strukturave vartëse në të cilat pasqyrohen ndalesat individuale të punonjësve për shpenzimet celulare (*këto listë pagesa (bordero) i janë paraqitur auditimit nga vetë shoqëria*).

5. Nga një pjesë të detyrimeve personale (individuale) të papaguara të ish-punonjësve apo punonjësve aktual të gjithë sistemit të MM, shpenzimet e të cilëve nuk mbulohen nga buxheti i shtetit, por nga vetë punonjësi, të cilëve nuk u është mbajtur detyrimi nga paga dhe nuk i është derdhur për llogari të ish-kompanisë "A..".

Sa sipër, për të gjithë detyrimin pretenduar të pa shlyer prej 53,116,286.6 lekë, shoqëria kërkon edhe pagesën e kamatëvonesave ligjore që do të paguhet nga Buxheti i Ministrisë duke pretenduar një vlerë të konsiderueshme që shkon deri në fund të korrikut 2018 rreth 55 milion lekë dhe së bashku me detyrimin shkojnë rreth 108 milion lekë.

II. Nga auditimi i kryer në Ministrinë e Mbrojtjes, në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit, për njohjen, regjistrimin në kontabilitet dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj ish-kompanisë "A.." në shumën e pretenduar nga shoqëria përmbartimore "D.. C.. & C.." në vlerën 53,116,286.60 lekë, evidentuam se:

1. Në zbatim të VKM-së 343, datë 11.07.2002 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë" i ndryshuar, MM ka nxjerrë urdhrin nr. 518, datë 20.08.2004. Në këtë urdhrë janë përcaktuar limitet e shpenzimeve telefonisë celulare që do të

mbulohen nga buxheti i shtetit vetëm për funksione të caktuar në VKM-së 343, datë 11.07.2002, si dhe është e përcaktuar se, çdo tejkalim i këtij limiti do të paguhet nga vetë përdoruesit. Ndërsa, për punonjësit e tjerë të MM dhe Njësive të Vartësisë që, nuk përfitojnë nga VKM-së 343, datë 11.07.2002, pra nuk u mbulohen shpenzimet e telefonisë celulare nga buxheti i shtetit, janë pajisur me numra telefoni celularë, sipas një marrëveshje të bërë midis MM dhe ish-kompanisë “A...” Konkretisht, gjatë periudhës nga viti 2005 deri në vitin 2010, disa Drejtorë Drejtorie apo Përgjegjës Sektori të MM kanë nxjerrë urdhra apo kërkesa dhe kanë lidhur kontrata, për tërheqjen e numrave celularë nga ish-kompania “A...” për të pajisur me këto numra punonjësit e gjithë sistemit të MM. Në të gjitha urdhrat është autorizuar një punonjës që në emër dhe për llogari të MM të monitorojë dhe realizojë shërbimet me ish- kompaninë “A...”. **Po kështu, në të gjitha urdhrat pa përjashtim është e përcaktuar se, detyrimet financiare do të përballohen nga Ministria e Mbrojtjes.** Siç duket, me këto urdhra dhe kontrata, MM ka marrë përsipër të jetë rregullator i marrëdhënieve të punonjësve të saj me ish-kompaninë telefonike “A...” Pra, sektorët e financave të njësive shpenzuese përkatëse, në bazë të faturave të ish-kompanisë “A...”, shpenzimet e telefonisë celulare të konsumuara për arsye personale nga punonjësit e pajisur me këto numra celulari, do ti zbriste nga paga e tyre (nga listëpagesat) dhe këto shuma nëpërmjet degës së thesarit do ti kalonin për llogari të ish-kompanisë “A...”. (Në tabelën bashkëlidhur, janë pasqyruar, urdhrat në bazë të të cilave janë tërhequr një pjesë e numrave (kartat) dhe janë lidhur kontratat me ish-kompaninë “A...” nga personi i autorizuar në emër të MM).

2. Gjatë zbatimit të kontratave për shlyerjen e detyrimeve të ish-kompanisë “A...” gjatë gjithë periudhës që nga viti 2005 deri në vitin 2012 MM, nuk ka likuiduar në kohë detyrimet financiare të cilat sipas dokumenteve të marra në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës janë në shumen totale **rreth 53,000,000 lekë** (bashkëlidhur lista e debitorëve). Këto detyrime, MM dhe Njësitë Vartëse të saj, nuk i kanë regjistruar në kontabilitet në mënyrë analitike për çdo punonjës që mbart detyrime të pa paguara, mbështetur në faturat tatimore të lëshuara nga ish-kompania “A...” Por, auditimi u njoh me këto detyrime nga disa dokumente të mbajtura nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të cilat nuk janë të rakorduara me njësitë shpenzuese (Njësitë Vartëse) si dhe nuk janë të shoqëruara me dokumente justifikues si, fatura të lëshuara nga ish-kompania “A...” listëpagesa (bordero), kontrata, etj. Kështu, detyrimi që i ka MM kësaj shoqërie në shumën rreth 53 milion lekë, nuk dihet se, çfarë përfaqëson dhe nga çfarë detyrimesh përbëhet, nga:

-Detyrime që i përkasin vetëm aparatit të MM për ish-punonjës apo punonjës aktual të Administratës së Ministrisë që, në zbatim të VKM-së 343, datë 11.07.2002 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë”, janë pajisur me numra celularë dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit (nga buxheti i MM).

-Detyrime që një pjesë e Njësive Vartëse i kanë pasur ish-kompanisë “A...”, për shërbimin e telefonisë fikse dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit (nga buxheti i Njësive Vartëse).

- Detyrime të papaguara për ish-punonjës apo punonjës aktual të njësive vartëse që në zbatim të VKM-së 343, datë 11.07.2002 , janë pajisur me numra celularë dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit (Njësitë Vartëse).

-Detyrime që ka vetë MM për ish-punonjësit apo punonjësit aktual, të cilëve u është mbajtur detyrimi nga paga, por ky detyrim nuk është derdhur nga sektori i financës nëpërmjet thesarit në llogari të ish-kompanisë “A...”.

- Detyrimet personale (individuale) të papaguara të ish-punonjësve apo punonjësve aktual të gjithë sistemit të MM, shpenzimet e të cilëve nuk mbulohen nga buxheti i shtetit, por nga vetë punonjësi, të cilëve nuk u është mbajtur detyrimi nga paga nga sektorët e financave përkatëse dhe nuk i është derdhur për llogari të ish-kompanisë “A...”.

KLSH, mbështetur në ato pak dokumente që ju paraqitën nga MM dhe nga vetë shoqëria ankuese mundi të evidentoi vetëm detyrime që i përkasin aparatit të MM për ish-punonjës

apo punonjës aktual të Administratës së Ministrisë që, në zbatim të VKM-së 343, datë 11.07.2002, janë pajisur më numra celularë dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit. Edhe ky detyrim nuk është i rakorduar saktësisht por, sipas MM është afërsisht 2,900,000 lekë. Ndërsa pjesa tjetër e mbetur e detyrimit prej 50,100,000 lekë që i ka MM shoqërisë siç u tha më lartë, nuk është i evidentuar dhe identifikuar nga se përbëhet.

Si konkluzion: Shoqëria “D..C...& C...” me korrespondenca të shumta shkresore zyrtare i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes shlyerjen e këtyre detyrimeve, por MM, deri më sot jo vetëm që nuk i ka shlyer të paktën detyrimet që duheshin paguar nga buxheti i shtetit, por nuk ka rakorduar me Njësitë Vartëse për të saktësuar të gjitha detyrimet që ka ndaj kësaj shoqërie dhe më pas të urdhëronte pagesat e menjëhershme. Si pasojë e këtyre veprimeve apo mosveprime, buxhetit të MM, mundë ti shkaktohet një dëm ekonomik i konsiderueshëm, sepse përveç detyrimeve që ka të paguara sipas faturave të ish-kompanisë “A..”, mundë të paguhen edhe kamatëvonesat ligjore. Këto kamatëvonesat të pretenduara dhe llogaritur nga shoqëria deri në korrik shkojnë **rreth 55 milion lekë** dhe do të vazhdojnë gjithnjë të rriten, sepse shoqëria është në të drejtën e saj ligjore për ti kërkuar dhe për ti marrë nëpërmjet vendimeve gjyqësore, përfundimi i të cilave mundë të zgjasë edhe për disa muaj apo vite të tjera .

Nisur, sa sipër, Rekomandojmë:

1. Ministri i Mbrojtjes, të ngrejë një grup pune të veçantë, për të analizuar dhe saktësuar vlerën e detyrimeve të pa paguara për punonjësit e administratës së Ministrisë që përfitojnë nga VKM-së 343, datë 11.07.2002 ”Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë”. Mbas saktësimit, të behet regjistrimi i detyrimeve në kontabilitet dhe të bëhet pagesa e menjëhershme të këtij detyrimi, me qëllim shmangien kostove të tepërta që mundë të vijnë nga aplikimi i kamatëvonesave ligjore.

Menjëherë

2. Ministri i Mbrojtjes, të ngrejë një grup pune të veçantë, për të analizuar dhe saktësuar vlerën e detyrimeve të pa paguara për:

2.1. Detyrimet e pa paguara të Njësive Vartëse që i kanë ish-kompanisë “A..”, për shërbimin e telefonisë fikse që shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit (nga MM). Mbas saktësimit, të behet regjistrimi i detyrimeve në kontabilitet dhe të bëhet pagesa e menjëhershme të këtij detyrimi, me qëllim shmangien kostove të tepërta që mundë të vijnë nga aplikimi i kamatëvonesave ligjore.

Menjëherë

2.2. Detyrimet papaguara për ish-punonjësit apo punonjësit aktual të Njësive Vartëse që në zbatim të VKM-së 343, datë 11.07.2002, janë pajisur më numra celularë dhe shpenzimet i mbulohen nga buxheti i shtetit. Mbas saktësimit, të bëhet regjistrimi i detyrimeve në kontabilitet dhe të bëhet pagesa e menjëhershme të këtij detyrimi, me qëllim shmangien kostove të tepërta që mundë të vijnë nga aplikimi i kamatëvonesave ligjore.

Menjëherë

2.3. Detyrimet e ish-punonjësve apo punonjësve aktual të njësive vartëse, të cilëve u është mbajtur detyrimi nga paga, por ky detyrim nuk është derdhur nga strukturat përgjegjëse nëpërmjet thesarit në llogari të ish-kompanisë “A..”. Mbas saktësimit, të behet regjistrimi i detyrimeve në kontabilitet dhe të bëhet pagesa e menjëhershme të këtij detyrimi, me qëllim shmangien kostove të tepërta që mundë të vijnë nga aplikimi i kamatëvonesave ligjore.

Menjëherë

2.4. Detyrimet personale (individuale) të papaguara të ish-punonjësve apo punonjësve aktual të gjithë sistemit të MM, shpenzimet e të cilëve nuk mbulohen nga buxheti i shtetit, por nga vetë punonjësi, të cilëve në zbatim të kontratave të lidhura me ish-kompaninë “A.” nuk u është mbajtur detyrimi nga paga, dhe për pasojë nuk kanë shlyer detyrimet ndaj ish-kompanisë “A...”. Mbas saktësimit, të behet regjistrimi i detyrimeve në kontabilitet dhe të bëhet pagesa e menjëhershme të këtij detyrimi, me qëllim shmangien kostove të tepërta që mundë të vijnë nga aplikimi i kamatëvonesave ligjore.

Menjëherë

3. Për detyrimet personale (individuale) të papaguara të ish-punonjësve apo punonjësve aktual të gjithë sistemit të MM, shpenzimet e të cilëve nuk mbulohen nga buxheti i shtetit, por nga vetë punonjësi, të cilëve në zbatim të kontratave të lidhura me ish-kompaninë “A..” nuk u është mbajtur detyrimi nga paga, dhe për pasojë nuk kanë shlyer detyrimet ndaj ish-kompaninë “A..”, **të ndiqet rruga administrative e ligjore për arkëtimin në arkën e Ministrisë të detyrimit dhe të me kamatëvonesat, nëse aplikohen, nga të gjithë ish-punonjësit apo punonjësit aktual, debitorë .**

Deri në 31.03.2019

4. Ministria e Mbrojtjes, të bashkëpunoj me shoqërinë “D..C.. & C...” për të konkretizuar një **marrëveshje mirëkuptimi**, me qëllim mos pagimin apo minimizimin e kamatëvonesave ligjore që kanë ardhur apo dhe mundë të vinë për arsyen e mospagimit në kohë të këtyre detyrimeve.

Menjëherë

5. Ministri i Mbrojtjes, të ngrejë një grup pune të veçantë, për të analizuar dhe vlerësuar, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e trajtuar më sipër, për secilin drejtues apo ish-drejtues dhe të kërkojë për personat përgjegjës marrjen e masave disiplinore e administrative, deri në kallëzim për ndjekje penale.

Menjëherë

22. GJYKATA KUSHTETUESE

Nga auditimi i ushtruar në Gjykatën Kushtetuese, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin financiar*”, për periudhën 01.01.2017 deri 31.10.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 165, datë 27.11.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1122/6, datë 27.11.2018, konstatohet se: *Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.*

Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit është përcjellë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet respektive për zbatimin e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **3** masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht **3**, janë zbatuar 1 dhe janë në proces **2**.

I. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë, të vitit 2019.

22. MINISTRIA E KULTURËS

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Kulturës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2017 trajtuar në

Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 49, datë 12.06.2018, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1264/8, datë 19.06.2018, konstatohet se: *Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", subjekti nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhej të vihej në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimeve.*

Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja brenda afatit 6 mujor, në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" sipas të cilit është përcjellë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ku pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

Nga ana e KLSH-së, me shkresat përcjellëse janë lënë **12** rekomandime gjithsej, nga këto, 4 propozime për përmirësime ligjore, 5 masa organizative, dhe 3 masa zhdëmtimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë:

- ✓ "Propozime për ndryshime apo përmirësime të legjislacionit" janë lënë **4 (katër)** rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht, nga këto është zbatuar 1, dhe janë në proces zbatimi, 3.
- ✓ "Masa organizative" janë lënë **5 (pesë)** rekomandime, janë pranuar plotësisht 4 (katër), te cilat janë zbatuar, ndërsa rezulton pa pranuar 1.
- ✓ "Masa për shpërbllim dëmi" janë lënë **3 (tre)** rekomandime për shumën 2,663 mijë lekë, të cilat nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar nga subjekti i audituar.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e plotë të rekomandimeve të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

5. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2016 – 2017 Ministria e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" kanë shqyrtuar/miratur projektzbatimin "Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit", mbështetur në "Propozim të pakërkuar" të bërë nga subjekti "H.." sh.p.k. për marrjen me qira të një objekti ndërtimi, magazinë (e cila nuk është monument kulture), pranë Qytetit Antik të Butrintit me qëllim vënien e saj në shfrytëzim për aktivitet tregtar bar - kafe- restorant. Vendndodhja e këtij objekti është në Parkun Kombëtar të Butrintit (PKB), në nënzonën "A", në të cilën zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

Në përgjithësi arsytimi për miratimin e projektzbatimit "Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit", bie ndesh me: Ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore":

- nenin 30 në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Zonat arkeologjike, në varësi të intensitetit dhe rëndësisë së gjetjeve arkeologjike, kategorizohen në zona "A" dhe zona "B". Zonifikimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në zonat arkeologjike "A" është e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor.*

- nenin 38 në të cilin është përcaktuar se ... *Çdo vendim i marre nga këshillat e rregullimit të territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura monument kulture ose në zonën e mbrojtur pranë një monumenti kulture, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm.*

- VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” i ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.12.2013, në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Nënzona qendrore e shënuar në hartë me shkronjën “A” me sipërfaqe prej 3,980 ha, që përcaktohen si nënzona me vlera të mëdha për natyrën dhe biodiversitetin. Në këtë zonë zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... etj.*

- Kombinimin e përcaktimeve të bëra midis nenit 4, pika 1, shkronja “b”, neni 5, 6 ... të ligjit 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, VKM nr. 693, datë 10.11.2005 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar” ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.12.2013 sipas të cilit ... *në PKB nënzona qendrore (në të cilin ndodhet dhe objekti) zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes ... janë të ndaluara ndërtime të çdo lloji ... etj.*

Referuar Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, ndërtimi “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Qytetin Antik të Butrintit”, nuk përbën trashëgimi kulturore etj, në kuptim të Ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, për rrjedhojë, Ministria e Kulturës (më parë IMT dhe KKR), duhet ta refuzonin kërkesën e subjektit “H...” sh.p.k.

Për sa më sipër rikërkojmë:

Ministria e Kulturës të kërkojë/anulojë kontratën e enfi-teozës nr. 360, datë 2.6.2017 me objekt “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve në Parkun Kombëtar të Butrintit” lidhur me subjektin “H...” sh.p.k. me argumentet e paraqitur hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit. Me realizimin e anulimit të kontratës marrin përgjigje, gjejnë zgjidhje dhe pasaktësi të tjera të evidentuara/trajtuara më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të APP të tenderit me objekt “Rehabilitimi i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” me fond limit 998,862,862 lekë i zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se në preventivin e punimeve është përfshirë si zë punimi (më vete) “Punime për ngritje kantieri”. Në preventivin e bashkimit të operatorëve ekonomikë (B.) “E.. A.- IT” sh.p.k. & “A.. k..” sh.p.k. fitues, *punimet për ngritje kantieri* janë paraqitur me vlerë 1,841,942 lekë, ose 1,934,039 lekë gjithsej (1,841,942 lekë x 1.05 fondi rezervë). Në preventiv/situacion (ndarja e punimeve) ky punim është parashikuar/realizuar nga OE “E.. A.- IT” sh.p.k.

Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen ... *Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj.* Nën këtë arsyetim **vlera** prej 1,934,039 **lekë gjithsej përbën dëm ekonomik**, e cila është përfituar padrejtësisht nga OE “E..A.- IT” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht nr. 36-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rikërkojmë:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,934,039 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, përfituar nga OE “E.. A.- IT” sh.p.k.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të APP të tenderit me objekt “Rikonstruksioni i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijët/Teatri i Kukullave dhe Qendrës Kombëtare të Veprimtarive të Folklorit”, me fond limit 47,835,830 lekë i zhvilluar në vitin 2015 me OE fitues “B...” sh.p.k., u konstatua se në

preventivin e punimeve të objektit janë përfshirë dhe zërat e punimeve “Rrethim i përkohshëm” me vlerë 120,000 lekë dhe “Rrethim rruge me rrjetë teli” me vlerë 20,000 lekë, ose *147,000 lekë gjithsej* (përfshirë dhe fondin rezervë përkatës në masën 5 për qind), në kundërshtim me pikën 3 të germës B “Shpenzimet e përgjithshme” të UKM nr. 2, datë 5.2.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostot së punimeve të ndërtimit” në të cilën është përcaktuar se ... *Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen ... Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj., për mbrojtjen në punë si trajtimi me veshmbathje, ushqime, antidot, ndihmë e shpejtë etj, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik (trajtuar në faqe nr. 64-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rikërkojmë:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **147,000 lekë gjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar nga OE “B...” sh.p.k.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me emërtim “*Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisje të tjera për strukturat e Vettingut*”, për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontratë me vlerë kontrate 552,000 lekë me subjektin “A...” sh.p.k. Sipas AK, ky veprim është i mbështetur në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Sa më sipër është në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 i ndryshuar, pasi ky udhëzim parashikon *mbikëqyrje*, për kontratat e zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe jo për *blerje mallra* etj, të kësaj natyre (*trajtuar më hollësisht nr. 79-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rikërkojmë:

Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **552,000 lekë gjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, përfituar padrejtësisht nga OE “A...” shpk.

Menjëherë

I. Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi të inkurajohet përshpejtimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të tretë, të vitit 2019.

10. TË TJERA MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE.

Rekomandimet e mësipërme që kanë rezultuar të pazbatuara nga auditimi i ushtruar “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar gjatë vitit 2018*”, do të përcillen në subjekte brenda datës 31/07 /2019.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R